

KONKURSI RAJONAL  
i PRAKTIKAVE dhe PROJEKTEVE  
TË MIRËMENAXHUARA

**2013**

Ky publikim është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Përgatitur nga:

**Aljon Kockiqi, Myftar Doci, Blendi Bushati**

Mbështetur nga:

**Valbona Karakaci, Arben Koplaku, Djana Bejko, Jonida Baci, Elvin Hoxha**

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)  
HELVETAS Swiss Intercooperation, Shkodër, Albania

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC.

Publikuar nga:

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)  
HELVETAS Swiss Intercooperation (HSI) Albania  
Copyright © HSI Albania

Rr. Oso Kuka, Nr. 11,  
4000 Shkodër, Albania  
[www.dldp.al](http://www.dldp.al)



Funded by



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
And Cooperation SDC



**HELVETAS**  
Swiss Intercooperation

**ALBANIA**

# Hyrje

Programi i Decentralizimit dhe Zhvillimit Vendor (dldp), një ndër programet kryesore të financuara nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), është në përmblyllje të Fazës së tij të dytë (2010-2013). Dldp synon të kontribuojë në zhvillimin e kapaciteteve vendore në qarqet Shkodër dhe Lezhë dhe në procesin e decentralizimit në Shqipëri në përgjithësi. dldp zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation (HSI). Një element i rëndësishëm i programit është ndarja e përvojave dhe praktikave të mira në nivel rajonal dhe kombëtar në mënyrë që të përfitojnë edhe Njësitë e tjera të Qeverisjes Vendore në vend. Në këtë kontekst, dldp-ja organizon për herë të dytë Konkursin Rajonal të Praktikave të Mira. Për herë të parë, ky konkurs u realizua nga dldp-ja në vitin 2010 dhe mësimet e fituara janë reflektuar në organizimin e Konkursit të dytë Rajonal. Në të njëjtën kohë, dldp-ja organizoi edhe konkursin e projektit më të mirë bashkëfinancuar nga programi nëpërmjet dy raundeve të fondit grant në NJQV-të e Qarqeve Shkodër e Lezhë. Më poshtë do jepen shkurtimisht proceset e dy konkurseve.

# 1. Konkursi Rajonal i Praktikave të Mira

Konkursi Rajonal i Praktikave të Mira synon promovimin dhe shkëmbimin e praktikave të mira të NJQV-ve të qarqeve Shkodër dhe Lezhë, në nivel rajonal. Objektivat e këtij Konkursi janë: Njohja dhe shkëmbimi i eksperiencave të mira të qeverisjes vendore në qarkun e Shkodrës dhe të Lezhës; dhe Nxitja e ideve novatore në fusha të ndryshme të kompetencës së qeverisjes vendore. Në këtë konkurs, morën pjesë Njësitë e Qeverisjes Vendore të qarqeve Shkodër dhe Lezhë, që kanë zbatuar projekte të suksesshme në fushën e qeverisjes vendore në pesë kategoritë e mëposhtme:

- Planifikimi strategjik,
- Menaxhimi financiar,
- Menaxhimi i mbetjeve,
- Informimi dhe komunikimi me qytetarët,
- Bashkëpunimi ndërvendor.

Përvojat e prezantuara nga NJQV-të përfaqësojnë praktika të realizuara në bashkëpunim me programe të mbështetjes apo nisma vetjake të NJQV-ve në rajonet Shkodër dhe Lezhë. Krahasuar me Konkursin e pare të zhvilluar në 2010, në përgjithësi janë ruajtur të njëjtat fusha, me ndryshimin që Shërbimet Publike janë zëvendësuar me Menaxhimin e Mbetjeve.

## **Metodologjia/Hapat e konkurrimit**

Vlerësimi i praktikave më të mira është bërë bazuar në ndryshimet që ato kanë sjellë në nivel komuniteti, qeverisjeje, dhe politikash. Kriteret kryesorë për vlerësimin e praktikave të paraqitura nga NJQV-të përfshijnë: Ndikimin në komunitet; Rezultatet e qarta; Përdorimin e metodave novatore;

Pjesëmarrjen e gjerë në zbatimin e praktikës nga Këshilli, komuniteti, etj.; Informimi i publikut rreth praktikës; Entuziazmi dhe motivimi që praktika përçon në komunitet; Mundësitë e replikimit të praktikës në NJQV-të e tjera; Qëndrueshmëria afat-mesme dhe afat-gjatë e praktikës; dhe Kujdesi për barazinë gjinore e përfshirjen sociale. Gjithashtu, praktikat që përfshinin qasje ndër-vendore ishin të inkurajuara.

NJQV-të e interesuara janë njoftuar për mundësinë e aplikimit nëpërmjet faqes së Internetit të dldp-së si dhe takimeve informuese të organizuara, takimeve direkte me përfaqësues të komunave dhe bashkive, e-mailit, etj. Gjithsej, 35 NJQV aplikuan, 22 të Qarkut Shkodër dhe 13 të Qarkut Lezhë (shih tabelat 1 dhe 2 në Aneksin 1 lidhur me aplikimet sipas fushave, qarqeve dhe tipit të NJQV).

Shumica e NJQV-ve kishin aplikuar edhe në konkursin e parë të praktikave më të mira në vitin 2010. Megjithëse ka një rënie të numrit të aplikimeve (nga 65 në vitin 2010 në 35 aplikime në 2013), llojet e praktikave për konkurrim në Konkursin e dytë janë më të qenësishme për veprimtarinë e NJQV-së. Kështu, NJQV-të kanë aplikuar për praktika të tilla si rishikimi e hartimi i planeve strategjike, hartimi i planeve të menaxhimit, hartimi i buxheteve vjetore dhe afatmesme, ngritja e Zyrave me Një Ndalesë (Z1N) dhe bashkëpunimi ndërvendor si dhe për projekte rajonale dhe ndërkufitare. Ndërsa në konkursin e parë janë përfshirë aspekte specifike të buxhetimit apo informim komunikimit, në konkursin e dytë janë përfshirë aspekte të plota të tyre si hartimi me pjesëmarrje i planeve vjetore dhe afatmesme, apo ngritje të Z1N me shërbime të plota për informimin dhe komunikimin me komunitetin, etj. Në Konkursin e parë Rajonal të Praktikave të Mira, një numër i konsiderueshëm i NJQV-ve (10) janë paraqitur me dy praktika në të njëjtën fushë. Nga ana tjetër, në numrin e aplikimeve në Konkursin e dytë ka ndikuar edhe zëvendësimi i fushës së shërbimeve publike, ku ishte numri më i madh i aplikimeve (28), me menaxhimin e mbetjeve, ku në këtë fazë kanë aplikuar 6 NJQV. 8 NJQV, që kanë marrë pjesë në Konkursin e vitit 2010, nuk kanë marrë pjesë në Konkursin e tanishëm. Këto të fundit, në pjesën më të madhe të tyre nuk kanë përfituar nga grantet e dldp-së. (Shih Tabelën 3/1 dhe 3/2 në Aneksin 1 për të parë detaje krahasuese të rezultateve të fazës së parë të vlerësimit në dy konkurset rajonale të vitit 2010 dhe 2013).

Numri i aplikimeve, sipas qarqeve dhe sipas tipit të NJQV-së (bashki apo komunë), është pak a shumë në përpjesëtim të drejtë me numrin e NJQV-ve. Sidoqoftë, ky përpjesëtim nuk qëndron për të gjitha fushat. Për shembull, në fushën e menaxhimit të mbetjeve, të gjithë aplikimet janë nga qarku i Shkodrës. Ndërsa, në menaxhimin fiskal e financiar, aplikimet nga qarku i Lezhës janë dy herë më shumë se ato nga qarku i Shkodrës. Edhe në fushën e informim komunikimit janë më shumë aplikime nga qarku i Lezhës sesa i Shkodrës. Në përgjithësi, numri i aplikimeve është i shpërndarë njëtrajtësisht. Më shumë NJQV kanë aplikuar në fushën e planifikimit strategjik.

Konkursi për praktikantë më të mira ka qenë i hapur për të gjitha NJQV-të e qarqeve Shkodër dhe Lezhë, përfitues ose jo të dldp 1 dhe 2. Konkursi përfshiu dy faza: (1) Fazën e parë për përzgjedhjen e 3 praktikave më të mira për secilën fushë; dhe (2) Fazën e dytë për përzgjedhjen e një fituesi për secilën fushë.

## **Vlerësimi i praktikave: Faza I**

Në fazën e parë, ato u vlerësuan nga grupet e punës sipas fushave të përbërë secili nga ekspertë të pavarur, programe të qeverisjes, dhe anëtarë të Këshillit të Qarkut. Aplikimet e NJQV-ve për secilën fushë janë vlerësuar mbi bazën e kriterëve të zhvilluara paraprakisht. Bazuar në pikët mesatare më të larta, u kualifikuan për në fazën tjetër të vlerësimit nga juritë, tre praktika për secilën fushë. Nga 15 praktikantë e kualifikuar, 6 ishin nga NJQV-të e Qarkut Lezhë dhe 9 të Qarkut Shkodër. Megjithatë, shumica e tyre kanë përfituar nga grantet e dldp-së, ka edhe NJQV që nuk kanë përfituar më parë si Blinishti apo Shllaku. Fituesit e fazës së parë të vlerësimit, në përgjithësi, janë të shpërndarë në përputhje me numrin e NJQV-ve në qarkun e Shkodrës dhe Lezhës. Tabela 4 në Aneksin 2 paraqet praktikantët e kualifikuar për vlerësim final sipas fushave dhe qarqeve.

Lidhur me përmbajtjen e projekteve të kualifikuara për t'u vlerësuar nga juritë, në krahasim me Konkursin e parë Rajonal (2010), vihen re risi në

praktikat që konkurrojnë. Kështu për shembull, ndërsa në 2010 praktikat në fushën e planifikimit strategjik ishin rreth planeve strategjike të zhvillimit, në vitin 2013 bashkia Shkodër dhe komuna Shllak konkurrojnë përkatësisht me praktikat “Mobiliteti Urban në Shqipëri” dhe “Fuqizimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave komunale në Shllak.”

## **Vlerësimi i praktikave: Faza II**

Në fazën e dytë, praktikat e përzgjedhura në fazën e parë u vlerësuan nga juri të specializuara sipas fushave. Tre praktika të secilës kategori u vlerësuan nga përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, ekspertë të programeve të ngjashme me dldp-në, teknikienë të ministrisë së linjave (sipas tematikave të përzgjedhura), përfaqësues të SDC-së e shoqatave vendore etj. Vlerësimi u bë sipas një formati që kombinonte shqyrtimin e përmbajtjes së praktikës si dhe prezantimin esaj.

Bazuar në prezantimin e përgatitur nga NJQV-të dhe dokumentet e aplikimit, juritë vendosën për praktikën më të mirë për secilën nga pesë fushat. Përmbajtja e praktikës u vlerësua bazuar në këto kritere: Suksesi; Ndikimi; Transparenca dhe pjesëmarrja; Novacioni; dhe Replikimi. Prezantimi i praktikës nga NJQV-të ishte një tjetër kriter bazë. Në këtë kontekst, juritë vlerësuan: Aftësitë prezantuese (entuziazmin dhe energjinë e përçar nga prezantuesi); Qartësinë; Përgjigjet e pyetjeve nga pjesëmarrësi; dhe Përdorimin efikas të kohës në dispozicion për prezantimin.

Vlerësimi i praktikave të mira nga juritë u përcoll nga përfaqësues të NJQV-ve të ndryshme, bashki dhe komuna, nga të dy qarqet. Ata ndoqën me interes prezantimet e praktikave nga NJQV-të e kualifikuara, bënë pyetje dhe morën përgjigje lidhur me çështje të ndryshme të qeverisjes lokale me interes edhe për Njësitë e tyre. Materialet ilustrative të përdorura nga prezantuesit ndihmuan në demonstrimin efikas të praktikave të mira, si dhe lehtësuan përfitimin nga NJQV-të e tjera pjesëmarrëse në aktivitetet.

## Konkluzione

- NJQV-të treguan më shumë përvojë dhe përgjegjësi për përfshirje në konkurrim duke aplikuar për praktika më të rëndësishme, përgjithësisht të ushtruara për disa vite me radhë dhe me interes për t'u ndarë në nivel rajonal. Kjo gjeti shprehjen e vet në maturinë e treguar lidhur me zgjedhjen e tematikave për aplikimet dhe plotësimin e tyre tërësisht nga stafet vendore. Krahasuar me Konkursin e parë, ku janë përfshirë aspekte specifike të buxhetimit apo informim komunikimit, në Konkursin e dytë janë përfshirë aspekte të plota të tyre si hartimi me pjesëmarrje i planeve vjetore dhe afat mesme, apo ngritje të Zyrave me Një Ndalesë me shërbime të plota për informimin dhe komunikimin me komunitetin.
- Konkurrimi i praktikave më të mira, ishte efektiv dhe eficient përsa i përket kohës dhe plotësimit të objektivave të tij. Eksperienca e fituar gjatë Konkursit të parë ndihmoi në përmirësimin si të përmbajtjes ashtu edhe të lehtësimit të procesit.
- Motivimi dhe interesimi i Njësive të Qeverisjes Vendore për të marrë pjesë në Konkurs dhe ndarë praktikatat e tyre të suksesshme me të tjerët në rajon dhe më gjerë ishin të lartë.
- Konkursi rikonfirmoi rolin e Ministrisë së Brendshme dhe shoqatave të vendorëve si aktorë që mund të garantojnë vijimin e kësaj platforme në funksion të performancës së përmirësuar të NJQV-ve duke krijuar një sistem motivimi dhe mësimi nga modelet pozitive.

## Anekset për konkursin e praktikave më të mira:

1. Paketa e Vlerësimit të Praktikave të Mira (faza e parë).
2. Lista e plotë e Praktikave të Mira të paraqitura për konkurrim.
3. Lista e Praktikave të përzgjedhura nga vlerësimi i parë.
4. Tabela Krahasuese e Praktikave të Mira pjesëmarrëse në Konkursin e Parë (2010) dhe të Dytë (2011)
5. Paketa e vlerësimit të Praktikave (faza e dytë).



## 2. KONKURSI PËR PROJEKTIN MË TË MIRË

dldp 2 ka mbështetur me anë të fondit grant një seri projektesh në Qarqet Shkodër dhe Lezhë me synim mbështetjen e iniciativave vendore për përmirësimin e shërbimeve publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore në këto dy qarqe. Projektet për t'u financuar janë përzgjedhur me anë të një procesi konkurrues bazuar në cilësinë e aplikimeve të sjella nga NJQV-të dhe kriterëve objektive vlerësuar nga ekspertë të Qarqeve përkatës dhe ekspertë të pavarur. Në dy raundet e programit (2011,2012) janë financuar 23 projekte në fushat e përmirësimit të shërbimeve publike dhe informim-komunikimit. Dldp-ja ka bashkëfinancuar projektet e NJQV-ve deri në 40,000 Euro. Në rastin e bashkëpunimit ndërvendor, limiti i financimit ka qenë dyfishi apo trefishi i kësaj shume në varësi të numrit të NJQV-ve pjesëmarrëse në projekt. Kontributi i detyrueshëm nga NJQV-të ka qenë të paktën 20 % e vlerës së projektit.

Mbështetja financiare nga dldp-ja për këto projekte është bërë drejtpërdrejt në buxhetin e tyre me një transh pas përfundimit të projektit. Zbatimi i projekteve, përfshirë prokurimin, ka qenë përgjegjësi direkte e NJQV-së fituese në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Në kuadër të objektivit të programit për promovimin e shpërndarjen e praktikave më të mira në nivel kombëtar, dldp 2 ka shpallur një konkurs për të vlerësuar projektin që është menaxhuar më mirë gjatë gjithë fazave të ciklit të menaxhimit të projektit. NJQV-ja, projekti i së cilës shpallet fitues, mbështetet nga dldp-ja me një grant prej 20,000 Euro, si mbështetje e drejtpërdrejtë buxhetore për këtë njësi. Edhe në fazën e parë të dldp-së janë realizuar dy konkurse të ngjashme ku njësitë vendore të Gurit të Zi e Dajçit të Bregut të Bunës kanë fituar mundësinë e mbështetjes me 10,000 Euro duke treguar potenciale të mira në menaxhimin e projekteve në shërbime publike e angazhim komunitar. Në krahasim me programin e parë, pjesëmarrja në aplikim ishte më e lartë dhe fushat e ndërhyrjes më të larmishme.

## **Metodologjia/hapat e konkurrimit**

NJQV-të e interesuara në Qarqet Shkodër e Lezhë (ato që kanë zbatuar një projekt me fondin grant të dldp) janë njoftuar për mundësinë e aplikimit nëpërmjet faqes së internetit të programit, por edhe me takime të drejtpërdrejta. Në këto takime janë shpërndarë edhe udhëzuesit e formatet e aplikimit për projektin më të mirë. 14 (katërbëdhjetë) NJQV me 11 (njëmbëdhjetë) projekte kanë aplikuar për këtë proces. Theksi në formatin e aplikimit vihej tek suksesi e impakti i krijuar nga zbatimi i projektit, inovacioni dhe ndikimi afat-gjatë në cilësinë e qeverisjes vendore. Projektet që aplikuan përfaqësonin të gjithë spektrin e projekteve të mbështetura nga fondi grant i dldp-së në fusha si shërbimet publike, informim-komunikimi, dhe menaxhimi i mbetjeve.

### **Vlerësimi i projektit më të mirë: Faza I**

Në fazën e parë të vlerësimit, një grup ekspertësh i përbërë nga organizata të pavarura me ekspertizë në fushën e menaxhimit të ciklit të projektit dhe projekteve të infrastrukturës, si dhe institucioneve (Ministria e Integritetit) e programeve që administrojnë procese të lidhura me grantet (Programi i Zhvillimit Rajonal Shkodër-Lezhë) ka bërë vlerësimin e projekteve mbi bazën e kriterëve të përcaktuara më përpara. Kriteret kanë të bëjnë me vlerësimin e përbushjes së objektivave të projektit dhe cilësisë së zbatimit të tij në faza të ndryshme të një cikli projekti (hartimi, prokurimi, zbatimi si dhe elementë cilësorë të transparencës, pjesëmarrjes, barazisë gjinore e qëndrueshmërisë së ndërhyrjes).

### **Vlerësimi i projektit më të mirë: Faza II**

Pesë projektet më të mira u kualifikuan për në fazën e dytë, ku një juri me përfaqësues nga donatori i programit, Ministria e Brendshme, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (Debaskon) dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit vlerësuan projektin e zbatuar më mirë përmes një liste kriteresh objektive të cilat i referoheshin: përbajtjes së projektit, prezantimit të tij nga vetë NJQV-të e vizitave në terren.

## **Konkluzione:**

- Shumica e Njësive Vendore të mbështetura nga projekti treguan interes për të aplikuar në konkursin e projekteve më të mira. Ky është edhe tregues i rritjes së besimit në aftësitë e veta për zbatim cilësor të projekteve.
- Puna e rëndësishme e programit në ngritje kapacitetesh të stafit të NJQV-ve për hartim, zbatim e monitorim projektsh e kombinuar me aftësimin tematik të tyre në sektorët, ku është përfituar investimi u përkthye qartë në cilësi mjaft të mirë të aplikimeve , ku Njësive u kërkohet të përmbledhnin rezultatet e përfitimet nga zbatimi i projekteve.
- Vlerësimi i cilësisë së aplikimeve nga specialistë të institucioneve vendore e qendrore shqiptare e ndërkombëtare është një përvojë e mirë që krijon shanse për replikimin e praktikave në aksesimin dhe menaxhimin e fondeve edhe në të ardhmen.

## **Anekset për konkursin e projektit më të mirë:**

Aneks 1: Formati i aplikimit për projektin më të mirë me udhëzimet përkatëse

Aneks 2: Kriteret e vlerësimit në fazën e parë

Aneks 2: Kriteret e vlerësimit në fazën e dytë

Aneks 4: Lista e projekteve që aplikuan dhe atyre që u kualifikuan për në fazën e dytë

## BLINISHT

### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Para zbatimit të praktikës, menaxhimi i mbetjeve linte shumë për të dëshiruar. Ngado kishte grumbuj mbeturinash si anash rrugëve, në përrrenj, pranë qendrave të banimit, etj. Ambienti ishte mbuluar nga ndotja dhe jeta e banorëve rrezikohej çdo ditë.

Shoqata ndërkomunale “Zadrime”, e krijuar para shumë vitesh, në të cilën bëjnë pjesë 5 njësi vendore, ndër të cilat edhe Komuna Blinisht, ka në fokusin e saj, ndërmjet të tjerash, organizimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Fillimisht, u krijuar një ndërmarrje e përbashkët për menaxhimin e mbetjeve, e cila drejtohet nga Presidenti i Shoqatës Ndërkomunale “Zadrime”. U blenë një makinë teknologjike për transportimin e mbetjeve dhe kazanë për hedhjen e mbeturinave të cilët u shpërndanë në fshatrat Troshan, Fishtë, Krajen dhe Kodhel. Struktura e ndërmarrjes përbëhet nga katër punonjës (një financier, 2 punëtorë dhe një shofer). Me anë të këtij organizimi u siguroi një mjedis më i pastër, si rezultat i një shërbimi të rregullt dhe me kosto më të ulët për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në landfillin e Bushatit.

**Praktika:** Bashkëpunimi Ndërvendor/  
Menaxhimi i Mbetjeve

**NJQV:** Komuna Blinisht

Qarku Lezhë

**Zbatimi:** Tetor 2011 e në vazhdim

**Produkti:** Ngritja e infrastrukturës për grumbullimin e mbeturinave në katër fshatrat e Komunës Blinisht, anëtarë të shoqatës ndërkomunale “Zadrime”.

### Rezultatet e arritura

- Rritja e informimit të banorëve dhe përfshirja e tyre në vendimmarrje përsa i përket menaxhimit të mbetjeve.
- Rritja e transparencës së Komunës Blinisht për përdorimin e fondeve dhe krijimi i një imazhi pozitiv për qeverisjen vendore.



## Informimi i qytetarëve

Për informimin e qytetarëve u përdorën metoda të ndryshme: U realizuan aktivitete sensibilizuese me komunitetin për rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve; Komuniteti u informua “derë më derë” dhe u sqarua për aplikimin e praktikës së re në menaxhimin e mbetjeve; U informuan dhe sensibilizuan nxënësit e shkollave lidhur me tema të ndryshme mjedisore; U shpërndanë fletëpalosje për komunitetin lidhur me tematika mjedisore.

## Risia e projektit

Organizimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në nivel ndërkomunal është një praktikë e mirë nga pikëpamja ekonomike. Si e tillë ajo mund të shërbejë si model edhe për Njësitë e tjera të Qeverisjes Vendore në Shqipëri.

Kjo praktikë është filluar dhe mbështetur nga COSPES (organizatë joqeveritare e financuar nga qeveria italiane) e cila ka ndihmuar shoqatën ndërkomunale “Zadrime” në fushën e menaxhimit të mbetjeve. COSPES ka financuar blerjen e kazanëve dhe ka mundësuar vizita në Itali për shkëmbimin e eksperiencave për stafet e njësisve vendore.

## Qëndrueshmëria e praktikës

Ka dy vite që kjo praktikë e menaxhimit të mbetjeve funksionon në Komunën Blinisht dhe në NJQV-të e tjera, anëtare të shoqatës “Zadrime”. Kjo praktikë do të shtrihet gradualisht edhe në fshatra të tjera të Komunës Blinisht.



### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Që në vitin 2009, Komuna Bushat kishte identifikuar si nevoja prioritare informimin e komunitetin dhe plotësimin e kërkesave-ankesave, detyrimeve fiskale, pagesave, etj. nga familjarët dhe bizneset dhe procesimin e tyre në kohë dhe me cilësi nga stafi i Komunës. Ngritja e Zyrës me Një Ndalesë (Z1N) në Komunën Bushat erdhi pikërisht si kërkesë e banorëve të Komunës për përmbushjen e këtyre nevojave. Madhësia e Komunës Bushat (24,300 banorë që jetojnë në 14 fshatra) e bënte edhe më të nevojshme ngritjen e Z1N. Me rikonstrukcionin e godinës së administratës, Komuna ia dedikoi një sipërfaqe prej 70 m<sup>2</sup> Zyrës me Një Ndalesë dhe gjeti financimin për ngritjen e saj.

Në kuadrin e ngritjes së Z1N, komuna realizoi me sukses dizenjimin e hapësirës fizike, mobilimin e saj, instalimin e pajisjeve (përfshirë edhe një monitor të madh informues) dhe të katër programeve/moduleve kompjuterike të lidhura me shërbime specifike publike. Gjithashtu, stafi i Z1N u trajnuar në informim-komunikim me publikun dhe menaxhim të Z1N. Struktura organizative e Komunës u rishikua duke integruar në të Z1N dhe duke reflektuar ndikimin e saj në zyrat e tjera. Në këtë kontekst, u krijuan zyra për pritjen e publikut (Z1N) dhe drejtoritë dhe zyrat prodhuese të dokumentacionit. Me pjesëmarrjen e të gjithë zyrave të Komunës u krijua një arkivë elektronike për kërkesë-ankesat, dokumentacionet e kërkuara nga qytetarët, dhe afatet e plotësimit/dorëzimit të tyre. U krijua një librari ligjore elektronike që mundëson qytetarët të njihen me aktivitetin e Komunës, përfshirë edhe vendimet e Këshillit. Gjithashtu kërkesë-ankesat dhe detyrimet fiskale mund të bëhen edhe në faqen e internetit të Komunës.

<b>Praktika:</b>	Ndërtimi i Zyrës me Një Ndalesë (Z1N).
<b>NJQV:</b>	Komuna Bushat Qarku Shkodër
<b>Zbatimi:</b>	Qershor – Tetor 2011
<b>Produkti:</b>	Zyra me Një Ndalesë e pajisur me stafin dhe teknologjinë e duhur për të ofruar shërbimet për qytetarët.

### Rezultatet e arritura

- Zyra me Një Ndalesë funksionale që ofron informim dhe komunikim të shpejtë, cilësor, dhe transparent për qytetarët e Komunës Bushat. Z1N ofron mjedise pritëse të kulturuar për publikun dhe kushte të mira pune për stafin e NJQV-së.
- Organogramë e re e Komunës Bushat që reflekton Z1N dhe ndikimin e saj në zyrat e tjera të Komunës.
- Kapaciteti i rritur i punonjësve të Komunës Bushat lidhur me informimin dhe komunikimin me qytetarët dhe përdorimin e moduleve kompjuterike të Z1N.
- Qytetarë të ndërgjegjësuar lidhur me përgjegjësitë e LGU-së në informim-komunikim dhe ofrimin e shërbimeve publike.



Komuna ka inkurajuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunitetit gjatë zbatimit të projektit. Sugjerimet e komunitetit janë marrë parasysh nga Komuna. Për shembull, me propozim nga komuniteti u përfshi vendosja e një monitori për informimin e publikut për Komunën dhe aktivitetet e saj. Gjithashtu, ky monitor bën të mundur edhe transparencën e veprimeve gjatë aplikimit të kërkesave, pagesës së taksave, dhe veprimtarive të tjera të Z1N.

## Risia e projektit

Komuna Bushat sheh si inovacion krijimin e një vizioni të ri në funksionimin e qeverisjes lokale dhe më konkretisht në ridizenjimin e funksioneve dhe detyrave të zyrave të saj nëpërmjet një rregulloreje të re. Kjo eksperiencë dhe rezultatet e saj mund të shpërndahen si praktikë e mirë në NJQV-të e tjera të qarqeve Shkodër dhe Lezhë.

Në kuadrin e projektit për ngritjen e Z1N, Komuna rishikoi organogramën e saj duke e integruar Zyrën me Një Ndalesë dhe duke përcaktuar rolin dhe përgjegjësitë e saj dhe të zyrave prodhuese të dokumentacionit. Kjo është një ndër kushtet e qëndrueshmërisë së rezultateve të Z1N. Funksionimi i Z1N shoqërohet me infomimin dhe zgjerimin e njohurive të komunitetit lidhur me shërbimet e Zyrës duke u përqendruar në: modernizimin e teknikave dhe metodave të informimit; efektivitetin e dhënies së informacionit; menaxhimin e punëve në formë elektronike; dhe komunikimin me publikun për pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje. Në të ardhmen, Komuna do të investojë në Z1N për të përmirësuar dhe plotësuar modulet e instaluara dhe plotësimin e arkivës elektronike.



## DAJÇ, SHKODËR

### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Deri në vitin 2009, Komuna Dajç nuk e ka ofruar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve edhe pse ishte i parashikuar në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e NJQV-së”. Plotësimi i nevojave të tjera emergjente, aftësitë e pamjaftueshme të stafit të komunës për hartimin e një plani për menaxhimin e mbetjeve dhe mundësitë e kufizuara financiare, kishin krijuar një mjedis të ndotur duke rrezikuar shëndetin e banorëve. Mbetjet organike dhe jo organike, të hedhura nga banorët në brigjet e lumit Buna, në kolektorë kullues e kudo, filluan të bëhen problem tepër shqetësues për Komunën dhe komunitetin e saj. Veçanërisht, emigrantët, të cilët ishin të shumtë në këtë Komunë, gjatë qëndrimit të tyre në vendlindje shpreheshin shumë të shqetësuar me situatën e krijuar. Ata në mënyrë të vazhdueshme dhe të organizuar, kanë nxitur Komunën për të përmirësuar gjendjen. Në këto kushte, në vitin 2010, Komuna Dajç vendosi në prioritetet e saj ushtrimin e funksionit të menaxhimit të mbetjeve.

Prej 3 vitesh, Komuna Dajç ofron shërbimin e pastrimit në të gjithë territorin e saj me një popullsi prej 8974 banorë dhe dendësi 237 banorë për km<sup>2</sup>. Realizimi i këtij shërbimi, fillimisht u mbështet nga dldp-ja, që në vitin 2010 financoi projektin “Hartimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane” për grumbullimin dhe depozitimin e mbeturinave.

**Praktika:** Menaxhimi i Mbetjeve Urbane

**NJQV:** Komuna Dajç

Qarku Shkodër

**Zbatimi:** 2010

**Produkti:** Dokumenti i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve; Infrastrukturë e ngritur për grumbullimin e transportimin e mbetjeve urbane (152 kontenierë, një makinë teknologjike 4 tonëshe).

### Rezultatet e arritura

- Komuna përfitoi një Plan të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane, i cili shërbeu si një material referimi për përmirësimin e shërbimit të pastrimit.
- Komuna u pajis me një infrastrukturë bazë për hedhjen e mbeturinave në kontenierët e vendosur nga projekti.
- Komuna krijoi një strukturë të caktuar për menaxhimin e mbetjeve, të përbërë nga 4 punonjës, e cila filloi të funksiononte sipas një rregulloreje të hartuar nga projekti.
- Komuniteti u ndërgjegjësua për hedhjen e Mbeturinave në vendet e caktuara dhe për pagesën e shërbimit të pastrimit.





## Informimi i qytetarëve

- Takime të hapura me grupet e interesit si emigrantë (të përfaqësuar nga shoqata Albamigrates), biznese, gra, të rinj të shkollës së mesme, punonjës të arsimit dhe shëndetësisë dhe punonjës të komunës, për hartimin e planit dhe përzgjedhjen e skemës së pastrimit.
- Fletë palosje të shpërndara për banorët pranë Z1N dhe nëpër fshatra për sensibilizimin e tyre lidhur me zbatimin dhe përfitimet e projektit.
- Organizimi i ditëve informative për çështjet mjedisore për nxënësit e shkollave.
- Informimi “derë më derë” i banorëve nëpërmjet aktivistëve dhe stafit të Komunës.
- Organizimi dhe realizimi i një anketimi në komunitet lidhur me monitorimin dhe matjen e cilësisë së këtij shërbimi.

## Qëndrueshmëria e praktikës

Që prej përfundimit të projektit, Komuna Dajç ofron shërbimin e pastrimit në mënyrë të rregullt, 3 herë në javë. Ajo ka planifikuar çdo vit buxhetin e nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve të shërbimit të pastrimit duke përfshirë shpenzimet për pagat e punonjësve, depozitimin e mbeturinave në landfillin e Bushatit, mirëmbajtjen e mjetit të transportit dhe kontenierëve, si edhe shpenzime të tjera operative. Këto shpenzime mbuloohen nga të ardhurat e Komunës të siguruar nga tarifat për shërbimin. Këto tarifa janë të diferencuara për familjet rezidente e jo rezidente, bizneset, institucionet arsimore e shëndetësore, etj. Aktualisht Komuna ofron një shërbim cilësor për banorët e saj dhe komuniteti është më i ndërgjegjësuar për mirëmbajtjen e vlerave mjedisore.



## GURI ZI

### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Në territorin e Komunës Guri Zi janë ruajtur traditat e punimeve tradicionale të artizanatit, kryesisht të produkteve të tezgjahut. Kjo ka qenë një nxitje për aplikimin në projektin ndërkufitar IPA/CBC. Projekti u fokusua në fushën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit (masa 1) dhe nëpërmjet tij u garantua një partneritet i qëndrueshëm publik-privat.

Projekti filloi implementimin e tij në shkurt 2011. Komuna Guri Zi, si aplikanti kryesor, siguroi partneritetin e duhur në çdo etapë dhe aktivitet të projektit. Projekti u bë i njohur në komunitet nëpërmjet publikimeve në qendrën informative dhe vizibilitetit të lartë që u siguroa.

Informimi i qytetarëve

- Promovimi, në të gjitha fazat e zbatimit të projektit, i bashkëpunimit ndërvendor dhe i financimit nga Komisioni i Bashkimit Evropian në të gjitha aktivitetet e projektit.
- Informimi dhe pjesëmarrja konkrete e komunitetit në implementimin e projektit.
- Pjesëmarrja konkrete e grave dhe vajzave në masën 90%, për realizimin e aktiviteteve të projektit si zhvillimi i filmit dokumentar, dizenjimi i markës së produkteve artizanale, ngritja e muzeut dhe realizimi i panairëve.

**Praktika:** Bashkëpunimi ndërvendor për projektin “Ndërtimi i rrugëve të bashkëpunimit turistik nëpërmjet zhvillimit të produkteve të artizanatit” IPA/CBC

**NJQV:** Komuna Guri Zi & Këshilli i Qarkut Shkodër  
Qarku Shkodër

**Zbatimi:** Shkurt 2011 - Maj 2012

**Produkti:** Dy panairë të artizanatit në Podgoricë dhe Shkodër; Marka e produkteve artizanale “ZAHOTEX”; Katalogu i artizanatit për të dy anët e kufirit; Film dokumentar për prodhimet artizanale; Muzeu Etnografik në Komunën Guri Zi

### Rezultatet e arritura

- Promovimi i produkteve artizanale në vendet ndërkufitare dhe përmirësimi i marrëdhënies dhe shkëmbimeve në fushën e turizmit në planin ndërkufitar.
- Rritja e kapaciteteve për respektimin e parimeve të partneritetit dhe marrjen e roleve dhe përgjegjësisë reciproke.



## Risia e projektit

Në nivel kombëtar, është projekti i parë që përfiton një njësi vendore në kuadrin e programit IPA/CBC të Bashkimit Evropian. Projekti është sensitiv jo vetëm në fushën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit por edhe në nxitjen e punësimit të grave në zonat rurale. Për herë të parë krijohet një markë shqiptare për produktet artizanale në Rajonin e Shkodrës. Gjithashtu, është rasti i parë që një markë e certifikuar menaxhohet nga një komunë.

## Qëndrueshmëria e praktikës

Qëndrueshmëria e projektit të zbatuar është siguruar nëpërmjet vënies në funksionim të Muzeut Etnografik. Për këtë është punësuar një person me kontratë dhe detyra të përshkruara për menaxhimin e muzeut dhe të markës. Gjithashtu, në paketën fiskale të vitit 2013 janë miratuar tarifrat e vizitave në muze, tarifrat e përdorimit të markës dhe të pajisjes me etiketën e markës "ZAHOTEX". Komuna Guri Zi ka aplikuar përsëri tek IPA/CBC për një projekt tjetër në fushën e energjisë dhe rinovueshmërisë së saj. Partnerët do të jenë të njëjtë me projektin e mëparshëm.



## KALLMET

### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Megjithëse në të kaluarën Komuna Kallmet ka qenë e përfshirë në aktivitete të ndryshme të planifikimit vendor, deri në vitin 2011 nuk kishte arritur të hartonte një plan të mirëfilltë strategjik, por kishte zhvilluar vetëm disa dokumente pjesorë planifikimi. Një ndër shkaqet kryesore të mungesës së PSZH-së ishte dhe kapaciteti i ulët i Komunës në planifikim dhe mungesa e fondeve për të financuar procesin e planifikimit.

Plani Strategjik i Zhvillimit (PSZH) i Komunës Kallmet u realizua nëpërmjet një projekti të Komunës në bashkëpunim dhe me financimin e dldp-së. Komuna Kallmet ngriti një grup të planifikimit të drejtuar nga Kryetari dhe me pjesëmarrës nga zyrat e ndryshme të Njësisë Vendore—financës, urbanistikës, gjendjes civile, bujqësisë, shërbimeve dhe arkivës. Gjatë procesit të planifikimit, një vëmendje e veçantë u kushtua rritjes së kapacitetit të stafit të Komunës në planifikim strategjik dhe pjesëmarrje qytetare nëpërmjet seminareve trajnuese. Grupi i planifikimit identifikoi “grupet e përfaqësimit” dhe të interesit dhe siguroi pjesëmarrjen e tyre në procesin e zhvillimit dhe zbatimit e të monitorimit të PSZH-së. Disa seminare planifikimi u organizuan për zhvillimin e komponenteve të planit. Procesi u kurorëzua me miratimin me unanimitet dhe konsensus të Planit Strategjik të Zhvillimit 2011-2015 nga Këshilli i Komunës. Gjatë dy viteve të para të PSZH-së (2011-2012), janë realizuar 48% të projekteve/aktiviteteve të përfshira në PSZH për arritjen e objektivave strategjike.

<b>Praktika:</b>	Hartimi i Planit Strategjik të Komunës Kallmet dhe zbatimi i tij.
<b>NJQV:</b>	Komuna Kallmet Qarku Lezhë
<b>Zbatimi:</b>	Dhjetor 2010 - Korrik 2012
<b>Produkti:</b>	Plani Strategjik i Komunës Kallmet.

### Rezultatet e arritura

- Komuna Kallmet ka një Plan Strategjik të Zhvillimit që qëndron në bazë të Planit Buxhetor Afatmesëm dhe projekteve të zhvillimit të Komunës.
- Kapaciteti i rritur i stafit të Komunës Kallmet lidhur me planifikimin strategjik dhe pjesëmarrjen qytetare.
- Ndërgjegjësim i rritur i komunitetit dhe grupeve të interesit lidhur me pjesëmarrjen e tyre në planifikimin e Njësisë Vendore.



## Informimi i qytetarëve

Procesi i zhvillimit të PSZH—së është karakterizuar nga planifikimi me pjesëmarrje. Grupi i planifikimit identifikoi aktorët kryesorë si—administrata, Këshilli, kryesitë e fshatrave, “të urtët”, Qarku, biznesi, gratë, përfaqësues të sektorëve të shëndetësisë, arsimit dhe kulturës, organizatat jo-fitimprurëse, komuniteti fetar, mediat lokale, etj.— dhe organizoi takime konsultative me to. Vizionimi u bë në bashkëpunim me palët e interesuara dhe deklarata e vizionit u prezantua si deklaratë e përbashkët për zhvillimin e ardhshëm të Komunës. Në bashkëpunim me grupet e “përfaqësimit qytetar” dhe të interesit u evidentuan fushat prioritare, potencialet e Komunës për zhvillim dhe sfidat që qëndrojnë para saj. Për pasojë dokumenti i hartuar është realist dhe adreson nevojat e komunitetit.

## Risia e projektit

Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Kallmet është zhvilluar ndryshe nga qasja klasike për zhvillimin e planeve strategjike. Për secilën objektivë strategjike, në përputhje me programin buxhetor afat-mesëm janë evidentuar projektet kapitale strategjike. Përfshirja e komunitetit në politikë-bërje, sikurse ndodhi gjatë zhvillimit të PSZH, është një tjetër risi e kësaj praktike.

## Qëndrueshmëria e praktikës

Në sajë të përfshirjes së Këshillit të Komunës në zhvillimin e PSZH-së së Komunës, ky plan u miratua nga Këshilli me konsensus dhe unanimitet. Kështu, PSZH-ja është një dokument i pranuar nga të gjithë aktorët politikë në Komunë. PSZH-ja qëndron në bazë të Planit Buxhetor Afatmesëm 2013-2015. Ai është në bazë të aplikimeve për financimin e projekteve të ndryshëm të Komunës nga qeveria apo donatorët. Gjatë dy viteve të para të zbatimit të PSZH (2012-2013), 48% e aktiviteteve të përfshira në plan janë realizuar.



## KOPLIK

### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Para 5 vitesh, Bashkia Koplik kishte një nivel jo të mirë të shërbimit të pastrimit për komunitetin e saj. Nuk kishte pika grumbullimi të caktuara dhe një vend depozitimi të përshtatshëm për hedhjen e mbeturinave. Bashkia nuk kishte shtrirje të shërbimit në të gjithë territorin e saj dhe një plan për menaxhimin e mbeturinave. Fondet ishin të pamjaftueshme dhe kapacitetet për hartimin e planit të menaxhimit të mbetjeve ishin të kufizuara. Si rezultat, mjedisi ishte i papastër dhe komuniteti ishte i pakënaqur me shërbimin e ofruar.

Në vitin 2008, Bashkia Koplik zbatoi një projekt për hartimin e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve, të bashkëfinancuar nga dldp. Tani, vizioni i Bashkisë për shërbimin e pastrimit është më i qartë dhe, vit pas viti, shërbimi i pastrimit po realizohet në përputhje me nevojat e komunitetit. Rreth 11,560 banorë janë përfitues të drejtpërdrejtë të këtij shërbimi në territorin e Bashkisë Koplik, nga të cilët 1,800 nxënës, 240 biznese si dhe të gjitha institucionet e tjera që janë të vendosura në qytetin e Koplikut.

<b>Praktika:</b>	Menaxhimi i mbetjeve urbane
<b>NJQV:</b>	Bashkia Koplik, Qarku Shkodër
<b>Zbatimi:</b>	Qershor 2008 e në vazhdim
<b>Produkti:</b>	Plani i Menaxhimit të Mbetjeve; Rregullorja e brendëshme për menaxhimin e mbetjeve. 30 kontenerie të vendosur në pika grumbullimi të ri-konstruara

### Rezultatet e arritura

- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve nga Bashkia Koplik.
- Infrastruktura e përmirësuar e menaxhimit të mbetjeve.
- Ndërgjegjësim i komunitetit për hedhjen e mbeturinave në vendet e caktuara dhe mirëmbajtjen e mjedisit në tërësi.



## Informimi i qytetarëve

Forma të ndryshme janë përdorur nga Bashkia Koplík për informimin e komunitetit si takime të organizuara mbi bazë lagjeje, biseda me përfaqësues të biznesit, takime me nxënësit për hedhjen e mbeturinave në vendet e caktuara, pamflete, programe televizive, etj. Bashkia iu ka kushtuar vëmendje takimeve me gratë pasi ato janë më të lidhura me çështjet e pastrimit dhe edukimin e fëmijëve për mjedisin. Aktivitetet e projektit (takimet e organizuara me gratë, nxënësit dhe përfaqësuesit e bizneseve) janë pasqyruar në TV Koplíku dhe TV Rozafa. Janë vendosur pamflete në fasadat e kontenierëve për mbajtjen pastër të ambientit dhe hedhjen e mbeturinave në vendin e duhur. Gjithashtu, janë organizuar nxënësit e shkollave kanë demonstruar nëpër qytet të veshur me bluza të bardha për të sensibilizuar qytetarët për një mjedis të pastër dhe të kulturuar.

## Risia e Projektit

Për herë të parë janë përdorur nga Bashkia Koplík parakalime në rrugë për sensibilizimin e qytetarëve për mjedisin.

Përfshirja e të rinjve në këtë ajktivitet ishte me shumë ndikim, kryesisht për familjarët e tyre të cilët janë më të sensibilizuar lidhur me shërbimet e Bashkisë.

## Qëndrueshmëria e praktikës

Buxheti për shërbimin e pastrimit është rritur nga viti në vit 5-8%. Brenda 2 viteve të fundit, taksa e pastrimit për qytetarët është dyfishuar (nga 1,250 lekë/familje në 2011 në 2,500 lekë/familje në vitin 2012). Ndërsa për vitin 2013, kjo tarifë është rritur në 3,500 lekë/familje. Bashkia po garanton vit pas viti mbulimin e kostove të pastrimit me të ardhurat nga pagesat e qytetarëve për shërbimin.



### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Qasja e integruar kundrejt shërbimeve për qytetarët dhe transparenca e Bashkisë lidhur me këto shërbime ishin baza për ngritjen e Zyrës me Një Ndalesë (Z1N) në Bashkinë e Lezhës. Para ngritjes së Z1N, situata lidhur me informimin dhe komunikimin e publikut linte për të dëshiruar. Qytetarët nuk dinin se në cilën zyrë duhet të drejtoheshin për të marrë shërbimet publike dhe shpenzonin shumë kohë për t'i përfituar ato. Përdorimi i metodave të punës dhe teknologjisë bashkëkohore ishte e kufizuar. Efiçenca e stafit dhe për pasojë performanca e Bashkisë, ishte e ulët.

Në kuadër të projektit për ndërtimin e Z1N, u bë përshtatja e një pjese të ndërtesës së Bashkisë për Z1N nëpërmjet rikonstruktimit të saj. Në këtë kontekst, u prishën tre zyra ekzistuese me një hapësirë të kufizuar dhe kushte të papërshtatshme pune dhe u krijua Z1N me hapësirë dhe kushte të përshtatshme për tetë poste pune. Njëkohësisht, u bënë instalimet e duhura për funksionimin normal të Z1N (rrjeti elektrik, Intraneti, Interneti, etj.) dhe zyra u kompletua me pajisjet bashkëkohore dhe softet e nevojshme për të ofruar shërbimet për qytetarët. Në vazhdim, të gjithë zyrat e Bashkisë që kanë komunikim me qytetarët dorëzuan tek Z1N praktikat e tyre. Sot, Z1N funksionon me efektivitet. Mesatarisht 120 qytetarë në ditë shërbehen nga stafi i Z1N dhe koha mesatare e procedimit të një kërkesë është ulur nga 2 orë në 15 minuta. Qytetarët mund të realizojnë brenda ditës shërbimin

<b>Praktika:</b>	One Stop Shop (Faza I): Mjedisi Fizik
<b>NJQV:</b>	Bashkia Lezhë Qarku Lezhë
<b>Zbatimi:</b>	2012
<b>Produkti:</b>	Zyra me Një Ndalesë e pajisur me stafin dhe teknologjinë e duhur për të ofruar shërbimet për qytetarët.

### Rezultatet e arritura

- Zyra me Një Ndalesë funksionale që ofron informim dhe komunikim të shpejtë, cilësor, dhe transparent për qytetarët e Bashkisë Lezhë. Koha e procesimit të një kërkesë është shkurtuar nga 2 orë në 15 minuta. Qytetarët mund të realizojnë brenda ditës shërbimin që oi u nevojitet.
- Kapaciteti i rritur i punonjësve të Bashkisë Lezhë lidhur me informimin dhe komunikimin me qytetarët.
- Qytetarë të ndërgjegjësuar dhe të informuar lidhur me përgjegjësitë e bashkisë lidhur me shërbimet publike dhe mënyrën e ofrimit të tyre.





## Informimi i qytetarëve

Përmirësimet në infrastrukturë kanë bërë të mundur orientimin e lehtë të qytetarëve drejt Zyrës me Një Ndalesë. Përveç punonjësve të Z1N që janë gjithnjë të gatshëm për të sqaruar vizitorët, ata marrin informacion nëpërmjet një ekrani të madh që pasqyron shërbimet kryesore që ofrohen nga Z1N dhe rrugën që duhet ndjekur nga qytetarët për t'i marrë ato.

## Qëndrueshmëria e praktikës

Bashkia Lezhë ndërmori iniciativën për ngritjen e Zyrës me Një Ndalesë dhe e financoi atë nga buxheti i brendshëm i saj. Pavarësisht nga vështirësitë që hasi në realizimin e këtij projekti, Bashkia ngriti me sukses Zyrën me Një Ndalesë. Ajo ka planifikuar buxhetin për mirëmbajtjen e Z1N dhe trajnimin e stafit të saj si dhe stafin e zyrave të tjera të Bashkisë që bashkëpunojnë me Z1N.



### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Para realizimit të këtij projekti, Komuna pak i kishte marrë parasysh kërkesat dhe ankesat e qytetarëve për përcaktimin e shërbimeve dhe investimeve në buxhetin vendor. Buxheti bëhej sipas interesave të personave ose grupeve të veçantë, drejtuesve vendorë, apo Këshillit të Komunës. Komuniteti kishte humbur besimin që qeverisja vendore dhe Këshilli i Komunës do të bënin një buxhetim të drejtë dhe në interes të qytetarëve.

Duke mos besuar që fjala e tij dëgjohej, ai nuk ishte aktiv. Për të rritur pjesëmarrjen qytetare dhe efektivitetin e investimeve në komunitet, Komuna Orosh vendosi të zbatojë buxhetimin me pjesëmarrje.

Në kuadrin e buxhetimit me pjesëmarrje, Komuna Orosh hartoi një plan pune për tërheqjen e qytetarëve në këtë proces. U caktua një grup pune përgjegjës për prezantimin e buxhetimit me pjesëmarrje në komunitet dhe zbatimin e tij. U organizuan takime me komunitetin në bazë lagjeje dhe fshatrash për t'i informuar anëtarët e komunitetit lidhur me përfitimin e drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë të tyre nga ky proces dhe tërheqjen e mendimit të tyre lidhur me buxhetin e Komunës. Bazuar në këto konsultime u bë edhe përzgjedhja e shërbimeve dhe investimeve në planin e buxhetit të Komunës.

<b>Praktika:</b>	Menaxhimi fiskal dhe financiar "Buxhetimi me pjesëmarrje".
<b>NJQV:</b>	Komuna Orosh, Qarku Lezhë
<b>Zbatimi:</b>	Mars 2008 – Dhjetor 2008
<b>Produkti:</b>	Plani i Buxhetit i bazuar në buxhetimin me pjesëmarrje.

### Rezultatet e arritura

- Komuna ka një plan buxheti në përputhje me strategjinë vendore dhe shërbimin ndaj qytetarëve.
- Pjesëmarrje e rritur e komunitetit në buxhetimin e Komunës.
- Është rritur besimi i komunitetit në drejtuesit vendorë dhe Këshillin e Komunës lidhur me buxhetimin e drejtë dhe në interes të komunitetit.



## Informimi i qytetarëve

Në mungesë të mediave lokale, komuniteti u informua nëpërmjet lajmërimeve publike të vendosura në qytetin e Repsit dhe fshatrat e Komunës Orosh dhe fletë-palosjeve të shpërndara shtëpi më shëpi. Gjithashtu komuniteti u informua nëpërmjet takimeve direkte ku morën pjesë mbi 780 banorë përfshirë edhe gra, grupe të marginalizuara, biznese, specialistë të arsimit dhe shëndetësisë, etj.

## Risia e projektit

Risia e këtij procesi ishte marrja në konsideratë e mendimeve të komunitetit dhe përzgjedhja e shërbimeve dhe investimeve bazuar edhe në sugjerimet e komunitetit. Në buxhetimin me pjesëmarrje kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm grash. Ky lloj buxheti është një praktikë e mirë që mund të vihet në zbatim edhe nga NJQV-të e tjera në Mirditë.

## Qëndrueshmëria e praktikës

Që kur u zbatua për herë të parë në 2008, metoda e buxhetimit me pjesëmarrje është zbatuar çdo vit nga Komuna Orosh. Kjo metodë ka dhënë rezultat lidhur me ndërgjegjësimin e komunitetit për të marrë pjesë në diskutimin e çështjeve vendore dhe rritjen e besimit të tij në qeverisjen vendore. Kjo vërtetohet edhe nga pjesëmarrja në rritje e komunitetit në buxhetimin me pjesëmarrje vit-pas-viti: Krahasuar me vitin 2008 kur morën pjesë 780 banorë (nga të cilët 298 femra), në buxhetimin me pjesëmarrje për vitin 2012-2013 kanë marrë pjesë 1570 banorë (nga të cilët 610 femra).



### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Shërbimi i pastrimit në territorin e Bashkisë Pukë ishte në një nivel të ulët. Rrugët dhe hapësirat publike ishin të papastrat nga moslargimi i mbetjeve urbane nga pikat e grumbullimit dhe hedhja e tyre pa kriter nga banorët. Gjithashtu, ujrat sipërfaqësore ishin të ndotura dhe fusha e depozitimit të mbetjeve po degradohej. Bashkia kishte një infrastrukturë jo të mirë pastrimi. Mjetet dhe pajisjet e transportit ishin të papërshtatshme. Mbeturinat nuk sistemoheshin por digjeshin në sheshin e depozitimit Fushë Qarri ishte jashtë standarteve të kërkuara në lejen mjedisore. Ndërgjegjësimi qytetar për mjedisin ishte i ulët. Koeficienti i arkëtimeve nga tarifat e pastrimit ishte i ulët dhe buxheti vendor për investime ishte i pamjaftueshëm. Në komunat Qerret e Rrape shërbimi i pastrimit mungonte, nuk kishte infrastrukturë dhe vend depozitimi të mbetjeve dhe skemë lokale për organizimin e këtij shërbimi. Përgjatë aksit rrugor Gomsiqe–Rrape kishte ndotje të madhe të territorit dhe shëndeti i banorëve ishte në rrezik.

Tre njësitë vendore, Bashkia Pukë dhe Komunat Qerret & Rrape, ndërmorën një projekt të përbashkët ndërvendor për të përmirësuar dhe zgjidhur problemet e pastrimit. Menaxhimi i mbetjeve po realizohet sipas një skeme më efektive dhe eficiente bazuar në një marrëveshje bashkëpunimi midis tre NJQV-ve, duke siguruar një përmirësim të ndjeshëm të shërbimit.

<b>Praktika:</b>	Bashkëpunimi ndërvendor
<b>NJQV:</b>	Bashkia Pukë, Qarku Shkodër
<b>Zbatimi:</b>	25 Korrik-7 Dhjetor 2012
<b>Produkti:</b>	Skema e menaxhimit ndërvendor të mbetjeve në NJQV-të Pukë, Qerret dhe Rrape. 1 makinë teknologjike, 62 kontenierë, 14 pika grumbullimi. Vend depozitimi i mbetjeve në Fushë-Qarri (i rikonstruktuar).

### Rezultatet e arritura

- Menaxhimi efektiv dhe eficient i mbetjeve urbane në tre njësitë vendore Pukë, Qerret dhe Rrape.
- Infrastrukturë e përmirësuar e mbetjeve.
- Ndërgjegjësim i komuniteteve përfutuese për mirëmbajtjen e mjedisit.
- Rritja e kënaqësisë së komunitetit për shërbimin e ofruar në të tre NJQV-të.



## Informimi i qytetarëve

Për informimin e qytetarëve, projekti përdori metoda të ndryshme përfshirë:

- Organizimi i takimeve me komunitetin për fillimin e projektit si dhe për konsultimin më të gjatë zbatimit.
- Organizimi i dy aksioneve komunitare (9 qershor dhe 12 nëntor 2012) me moton për një mjedis të pastër në qendrat e 3 NJQV-ve dhe në sheshin e vend depozitimit në Fushë Qarri.
- Pasqyrimi në televizionin lokal i takimeve dhe aksioneve të ndërmarra me komunitetin si dhe gjendjes para dhe pas përfundimit të projektit.
- Organizimi i një spoti publicitar në televizionin lokal.
- Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve sensibilizuese si postera (280 copë), bluza (30 copë), qese plastike (2000 copë) dhe doreza (1000 palë).
- Anketimi i komunitetit lidhur me kënaqësinë e tij për projektin. 80% e të anketuarve në Bashkinë Pukë dhe 70% në Komunat Qerret dhe Rrape u shprehën të kënaqur.

## Risia e projektit

Projekti ishte një përvojë pozitive për Bashkinë Pukë, si lider në këtë bashkëpunim ndërvendor. Kjo përvojë do të shërbejë si model për identifikimin e fushave të tjera të rëndësishme të bashkëpunimit ndërvendor me njësi të tjera vendore, kryesisht ato të Qarkut Shkodër.

## Qëndrueshmëria e praktikës

Bashkia Pukë dhe Komunat Qerret dhe Rrape kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi ndërvendor për funksionimin e shërbimit pas përfundimit të financimit nga dldp. Bashkia Pukë ka përfshirë në buxhetin vjetor të vitit 2013 një buxhet prej 4,852,000 lekë për pastrimin e rrugëve, shesheve e sipërfaqeve të gjelbërta të Bashkisë dhe evadimin e mbetjeve urbane. Vitet e ardhshme, buxheti vjetor i Bashkisë Pukë për pastrimin do të rritet. Administrata e Bashkisë Pukë do të marrë masa për mbulimin e kostove nga arkëtimet e pagesave për shërbimin e pastrimit.

Gjithashtu, Komunat Qerret dhe Rrape kanë përfshirë në buxhetet përkatëse shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve urbane.



### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Sipas Anketës së Udhëtimit Shtëpiak (2011), qyteti i Shkodrës ka një ndarje modale të veçantë të lëvizshmërisë: 44% ecje; 29% pedalim; dhe 3% transport publik. Përqindja e kombinuar ecje-pedalim (73%) e bën Shkodrën të ketë një stil urban të transportit të dallueshëm dhe “aktiv, të pastër dhe eficient” sipas standardeve perëndimore. Dikur ecja dhe pedalimi konsideroheshin mënyrat e transportit të të varfërve. Bashkia e Shkodrës e sheh këtë mënyrë transporti si një aset strategjik në zhvillimin urban dhe ekonomik (përfshirë turizmin) të Shkodrës dhe ruajtjen e mjedisit. Çështja është: Si të ruhet dhe modernizohet pedalimi, ecja dhe transporti publik?

Në bashkëpunim me projektin “MOBALB”, Bashkia Shkodër realizoi një projekt “fillestarësh” në lëvizshmërinë dhe qëndrueshmërinë urbane. Në këtë kuadër u realizuan sondazhe për modelet, tendencat, kërcënimet dhe mundësitë e mobilitetit urban. U zhvilluan anketa shtëpiake, harta e aksidenteve rrugore, dhe sondazhi mbi udhëtimin shtëpi-shkollë dhe shtëpi-punë. U bë një analizë mbi marrëdhëniet midis zhvillimit strategjik urban dhe lëvizshmërisë urbane. Paralel me këto aktivitete u zhvillua kapaciteti i personelit të shërbimeve publike dhe urbanistikës për formulimin dhe programimin e politikave mbi lëvizshmërinë urbane të qëndrueshme (PLUQ). Qyteti i Shkodrës mori çertifikatën BYPAD. U krijua organizata jo-qeveritare GO2.

**Praktika:** “Mobalb” Mobiliteti Urban në Shqipëri, Demo Shkodër.

**NJQV:** Bashkia Shkodër Q arku Shkodër

**Zbatimi:** Prill 2010 - Tetor 2012

**Produkti:** Analiza e marrëdhënies midis zhvillimit strategjik urban dhe lëvizshmërisë urbane.

### Rezultatet e arritura

- Bashkia ka analizën e marrëdhënies midis zhvillimit strategjik urban dhe lëvizshmërisë urbane në qytetin e Shkodrës.
- Ndërgjegjësim i rritur i qytetarëve lidhur me përdorimin e mënyrave aktive, të pastra dhe eficiente të transportit si ecja, pedalimi dhe transporti publik.
- Kapaciteti i rritur i personelit të shërbimeve publike dhe urbanistikës për formulimin dhe programimin e politikave mbi lëvizshmërinë urbane të qëndrueshme.



## Informimi i qytetarëve

Metoda të ndryshme janë përdorur për të bërë informimin e qytetarëve lidhur me përdorimin e mënyrave aktive, të pastra dhe efçente të transportit përfshirë: Paradë me biçikleta dhe fletë-palosje (“Paradë Fashion”); “Dita e Biçikletës”; Video; Fushata “Pedalimi Shkodran—traditë e madhe, e ardhme e ndritur; Faqja e Internetit ( ) dhe rrjeti social Facebook (“Shkodra Cycling City”); Konferenca rajonale mbi planifikimin e lëvizshmërisë urbane të qëndrueshme; Ekspozitë fotografike mbi lëvizshmërinë shkodrane që nga fillimet e shekullit XX; etj.

## Risia e projektit

Inovacioni lidhet si me përmbytjen e praktikës ashtu edhe me metodologjinë e saj. Ky projekt

është fokusuar në një temë—lëvizshmëria urbane e qëndrueshme—disi e ndryshme nga temat e zakonshme të NJQV-ve. Gjithashtu metodat e përdorura—sondazhet, certifikata BYPED, futja e Shkodrës në intenerarin EuroVelo8—janë novatore.

## Qëndrueshmëria e praktikës

Bashkia Shkodër e sheh veten si lider në Shqipëri dhe rajon në Mobilitetin Urban dhe është aktive për të siguruar financimin e projekteve që synojnë mbështetjen e mobilitetit urban brenda strategjisë së adoptuar. Janë shkruar projekt-fishat për të siguruar vazhdimësinë e projektit. Në bashkëpunim me Tivarin është aplikuar në kuadrin e CBC Shqipëri-Mali i Zi për PLUQ. Në 2013, në buxhetin e Bashkisë është përfshirë edhe punësimi i një specialisti mobiliteti. Bashkia gjithashtu ka ofruar hapësirë zyre dhe mjete pune për OJQ-në G02.



## SHLLAK

### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave përfshin shumë aktorë në nivel lokal dhe qëndror. Më parë, menaxhimi i tyre bëhej direkt nga shteti. Ndryshimet gjatë dy dekadave të fundit rezultuan edhe në përgjegjësi të paqarta të aktorëve të ndryshëm që shpesh mbivendoseshin. Kjo çoi në konflikte dhe praktika të paqëndrueshme. Në vitin 2008, qeveria miratoi transferimin e pronësisë së 60% të pyjeve dhe kullotave komunale tek Njësitë e Qeverisjes Vendore. Në këtë kontekst, Komuna Shllak vendosi për zbatimin e një projekti që synon mbështetjen për aktorët kryesorë në përmbushjen e roleve dhe përgjegjësisë të tyre lidhur me menaxhimin e pyjeve dhe kullotave të Komunës Shllak duke kontribuar kështu në zhvillimin lokal më të barabartë dhe përfshirës.

Në kuadrin e këtij projekti u realizuan një sërë aktivitete të rëndësishme përfshirë: Hartimi i Planit Strategjik për Pyjet dhe Kullotat komunale; Hartimi i Planit Vjetor të punimeve në pyje; Ndarja e pyjeve dhe kullotave sipas përdoruesve dhe hartografimi i tyre; Përgatitja e hartave për regjistrimin e pyjeve në zyrat shtetërore të regjistrimit të pasurive; Zhvillimi i skemës së mbledhjes së taksave dhe skemës së ri-investimit në pyje; Zhvillimi i modeleve të menaxhimit të pyjeve komunale, agropylltarisë dhe pyllit të fermerit; Ndërtimi i rrjeteve rajonale të prodhuesve të pyjeve dhe organizimi i panairëve me produkte lokale; dhe Fuqizimi i shoqatave të përdoruesve të pyjeve nëpërmjet takimeve informuese dhe ndërgjegjësuere.

<b>Praktika:</b>	Fuqizimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave komunale në Shllak.
<b>NJQV:</b>	Komuna Shllak Qarku Shkodër
<b>Zbatimi:</b>	2010 - 2013
<b>Produkti:</b>	Plani Strategjik për Pyjet dhe Kullotat Komunale; Plani Vjetor i punimeve në pyje; Hartat e pyjeve dhe kullotave; Skema e mbledhjes së taksave dhe skema e ri-investimit në pyje; Modelet e menaxhimit të pyjeve komunale, agropylltarisë dhe pyllit të fermerit.

### Rezultatet e arritura

- Komuna Shllak ka dokumentet bazë për zhvillimin dhe menaxhimin e pyjeve dhe kullotave komunale (planin strategjik, plane vjetore të punimeve në pyje, harta të pyjeve dhe kullotave, dhe modele të menaxhimi të pyjeve dhe kullotave).
- Kapaciteti i rritur i stafit të Komunës Shllak lidhur me planifikimin dhe pjesëmarrjen qytetare në përgjithësi dhe planifikimin strategjik të pyjeve dhe kullotave dhe menaxhimin e tyre në veçanti.
- Ndërgjegjësimi i rritur i komunitetit dhe përdoruesve lidhur me menaxhimin efektiv të pyjeve dhe kullotave komunale.





## Informimi i qytetarëve

Komuna Shllak i ka kushtuar vëmendje të veçantë informimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit, sidomos përdoruesve të pyjeve dhe kullotave komunale, në zhvillimin e planeve dhe modeleve të menaxhimit të tyre. Në këtë kontekst, janë organizuar mbi 100 takime me më shumë se 700 pjesëmarrës nga grupet e fermerëve dhe anëtarët e Shoqatës së Pyjeve dhe Kullotave Komunale (rreth 40% e pjesëmarrësve kanë qenë femra). Shoqata e Pyjeve është përfshirë në çdo aktivitet planifikues, vendim-marrës dhe zbatues të lidhur me menaxhimin e pyjeve komunale. Janë organizuar vizita në rajone të ndryshme të vendit duke ndarë me to eksperiencën e Shllakut. Gjithashtu, janë organizuar aktivitete të ndryshme promovuese dhe ekonomike me pjesëmarrje lokale dhe kombëtare.

## Inovacioni

Komuna Shllak është ndër 10 komunat pilot që zbatojnë një projekt të tillë në zbatim edhe të ligjit të ri mbi pyjet në Shqipëri. Në këtë kuptim, aktivitetet

e projekti janë risi në Komunë dhe në vend. Mësimet e nxjerra nga zbatimi i tij do të ndihmojnë Njësitë e tjera Vendore në menaxhimin e pyjeve dhe kullotave komunale.

## Qëndrueshmëria e praktikës

Komuna Shllak ka menduar seriozisht edhe për të siguruar vazhdimësinë e kësaj praktike. Komuna ka zhvilluar një skemë të ri-investimit të të ardhurave që gjenerohen nga taksat dhe tarifat nga pyjet për mbështetjen e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave. Komuna ka investuar edhe për zhvillimin e kapaciteteve të stafit në menaxhimin e pyjeve dhe kullotave. Ajo ka punësuar dy specialistë pyjesh që janë përgjegjës për pyjet dhe kullotat komunale. Komuna po zhvillon dokumente të tjerë strategjikë në mbështetje të zhvillimit dhe menaxhimit të pyjeve dhe kullotave komunale si Strategjinë e Komunikimit me aktorët në pyjet dhe kullotat komunale për përfshirjen e tyre në vendim-marrje dhe menaxhim të pyjeve dhe kullotave dhe Strategjinë 25-vjeçare të Zhvillimit të Pyjeve dhe Kullotave Komunale.



### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Komuna Velipojë nuk kishte përvojë në ofrimin e shërbimeve ndaj komunitetit në fushën e informim-komunikimit. Një gjë e tillë kishte sjellë mungesën e transparencës së pushtetit vendor ndaj banorëve të zonës dhe biznesit. Organizimi i punës në drejtim të evidentimit dhe arkëtimit të të ardhurave vendore ishte i dobët. Në vitin 2010, ajo ka arkëtuar rreth 20,000,000 lekë të ardhura vendore, shifër që është mjaft e ulët në raport me kapacitetet dhe mundësitë që ka Komuna veçanërisht në fushën e turizmit. Komuna nuk kishte të dhëna statistikore për hartimin e buxhetit afat-mesëm dhe afat-gjatë për zhvillimin ekonomik të Komunës.

Për të përmirësuar situatën në drejtim të informim-komunikimit me qytetarët dhe për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët, Komuna Velipojë vendosi për ngritjen e Zyrës me Një Ndalesë (Z1N). Në këtë kuadër, po bëhet rehabilitimi i hapësirës fizike në Komunë për vendosjen e Z1N. Janë blerë pajisjet e nevojshme dhe është trajnuar stafi në marrëdhënie me publikun dhe përdorimin e moduleve kompjuterike lidhur me shërbimet publike për qytetarët. Ndërkohë, zyrat prodhuese të dokumentacionit kanë përgatitur të dhënat për bankën e të dhënave për modulet. Komuna ka punuar me komunitetin për rritjen e ndërgjegjësimit të tij lidhur me marrëdhëniet e NJQV-së me qytetarët.

**Praktika:** Informim, komunikim dhe shërbim online ndaj qytetarëve, turistëve dhe bizneseve nëpërmjet Z1N.

**NJQV:** Komuna Velipojë  
Qarku Shkodër

**Zbatimi:** Mars 2012 – Prill 2013

**Produkti:** Zyra me Një Ndalesë e pajisur me stafin dhe teknologjinë e duhur për të ofruar shërbimet për qytetarët (në proces).

### Rezultatet e arritura

- Zyra me Një Ndalesë funksionale që ofron informim dhe komunikim të shpejtë, cilësor, dhe transparent për qytetarët e Komunës Velipojë dhe e ndërlidhur me Zyrën e Informacionit Turistik duke ofruar shërbime edhe për pushuesit në plazhin e Velipojës (rezultat i pritshëm).
- Kapaciteti i rritur i punonjësve të Komunës Velipojë lidhur me informimin dhe komunikimin me qytetarët dhe përdorimin e moduleve kompjuterike të Z1N.
- Qytetarë të ndërgjegjësuar lidhur me përgjegjësitë e LGU-së në informim-komunikim dhe ofrimin e shërbimeve publike.



## Informimi i qytetarëve

Komuna ka zhvilluar takime me grupe të interesit lidhur me funksionimin e Z1N përfshirë banorët vendas, bizneset dhe agjencitë turistike që operojnë në zonën turistike, etj. Komuna ka planifikuar të realizojë takime mujore me banorët e Velipojës për të pasqyruar ndikimin e Z1N dhe problemet që mund të kenë banorët. Gjithashtu ajo do të vendosë “kutinë e ankesave” dhe do të administrojë një pyetësor me banorët e Komunës. Komuna ka zhvilluar faqen e internetit ku qytetarët dhe personat e tjerë të interesuar mund të marrin informacion mbi Velipojën ([www.komunavelipoje.gov.al](http://www.komunavelipoje.gov.al)).

## Risia e projektit

Z1N do të funksionojë e lidhur me Zyrën e Informacionit Turistik. Në këtë mënyrë do të ketë komunikim, shqyrtim dhe informim edhe të kërkesë-ankesave të 200,000 pushuesve që frekuentojnë Velipojën gjatë sezoni veror. Për t’ju shërbyer më mirë bizneseve lidhur me detyrimet fiskale, nxjerrja e faturave do të mundësohet të

bëhet online në faqen e internetit. Në këtë mënyrë do të rritet transparenca, do të ulët informaliteti dhe evazioni fiskal, do të eliminohen zvarritjet, dhe për pasojë do të rriten të ardhurat vendore.

## Qëndrueshmëria e praktikës

Komuna ka planifikuar një buxhet të veçantë vjetor prej 500,000 lekë për mirëmbajtjen e Z1N (lyerje, pastrim, administrim dhe kontroll periodik të sistemit kompjuterik). Në organogramën e Komunës është krijuar një Drejtori e veçantë për menaxhimin e Z1N me një staf prej 5 punonjësish (Drejtori, 3 punonjës—një për secilin modul, dhe mirëmbajtësi i sistemit dhe faqes së Internetit—IT) me një kosto vjetore të fuqisë punëtore prej 3,000,000 lekë.



### PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS

Vitet e fundit, krahas ndryshimit të kushteve të jetesës së banorëve, u rritën ndjeshëm mbeturinat nga konsumi dhe ambalazhet e ndryshme të grumbulluara e hedhura kudo në territorin e pesë njësive vendore që përfshijnë Dajç dhe Blinisht të Qarkut Lezhë dhe Vau i Dejës, Bushat e Hajmel të Qarkut Shkodër. Peizazhi i 25 fshatrave u dëmtua rëndë nga vend depozitimet abuzive të pranishme kudo. Shëndeti i banorëve u rrezikua nga dekompozimi i mbeturinave dhe ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Situata e krijuar u kthye në një shqetësim si për vetë Njësitë e Qeverisjes Vendore ashtu edhe për komunitetet e tyre.

Zgjidhja e problemeve të krijuara ishte e kushtueshme, kërkonte kapacitete të specializuara dhe nuk mund të përballohej nga njësitë vendore më vete. Në këto kushte, pesë njësitë vendore u organizuan për ofrimin e shërbimit të pastrimit së bashku. Të favorizuara edhe nga landfilli ekzistues i Bushatit, pesë njësitë vendore, anëtare të Ndërkomunales Zadrime, hartuan dhe aprovuan një marrëveshje të përbashkët, në të cilën shprehej angazhimi dhe vullneti për bashkëpunim midis tyre në ofrimin e shërbimit të pastrimit. Si rezultat i kësaj marrëveshje, u krijua një Njësi Ekonomike, e përbërë nga 4 punonjës (1 përgjegjës dhe 3 punëtorë), e cila aktualisht realizon shërbimin në 25 fshatra.

<b>Praktika:</b>	Administrimi i përbashkët i pesë njësive vendore
<b>NJQV:</b>	Komuna Dajç & Komuna Blinisht, Qarku Lezhë Bashkia Vau Dejës dhe Komunitat Bushat & Hajmel, Qarku Shkodër
<b>Zbatimi:</b>	Janar 2011 e në vazhdim
<b>Produkti:</b>	Krijimi i Njësisë Ekonomike për ofrimin e shërbimit të pastrimit në 25 fshatra të 5 njësive vendore, anëtarë të Ndërkomunales Zadrime.

### Rezultatet e arritura

- Ndërgjegjësim i komuniteteve përfituese për mirëmbajtjen e mjedisit nga mbeturinat dhe për qëndrimin kritik ndaj shërbimit të ofruar.
- Ofrimi i rregullt i shërbimit të pastrimit në komunitetet përfituese dhe monitorimi i tij nga njësitë vendore, anëtare të
- Ndërkomunales Zadrime.



## Informimi i qytetarëve

U krijua një grup të rinjsh nga të pesë komunat anëtare të Ndërkomunales Zadrime të cilët u trajnuan për çështjet e mjedisit dhe shërbyen si animatorë të territorit. Ata bënë sensibilizimin “derë më derë” të banorëve dhe organizuan asambltë e hapura me pjesëmarrjen e banorëve, veçanërisht të grave. Në këtë drejtim është për tu nënvizuar mbështetja dhe ndihma nga kryepleqtë e fshatrave dhe punonjësit e NJQV-ve, veçanërisht punonjësit e Zyrave të Mjedisit. U organizuan orë informative për mjedisin nëpër shkolla dhe ekspozita me produkte të përgatitura nga vetë nxënësit prej materialeve plastike të riciklueshme. Për informimin e qytetarëve u përdorën mediat vizive dhe të shkruara emisionet dhe spotet publicitare, dhe shpërndarja e fletëpalosjeve dhe broshurave për të gjithë komunitetet.

Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë aprovuar buxhetet vjetore për shërbimin e pastrimit, bazuar në të ardhurat e pritshme nga tarifat e pastrimit. Buxhetet propozohen nga Komiteti i Drejtimit të Bashkëpunimit Ndërvendor dhe miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ndërkomunales Zadrime. Çdo njësi vendore ka Zyrën e Mjedisit nëpërmjet të së cilës monitorohet ecuria e shërbimit të ofruar. Njësitë vendore delegojnë fondet e nevojshme për kryerjen e shërbimit të pastrimit bazuar në situacionet financiare të përgatitura prej tyre. Komuniteti e ka mirëpritur këtë iniciativë dhe ka mbështetur vazhdimësinë e tij për ofrimin e shërbimit të pastrimit.

## Risia e Projektit

Organizimi i shërbimit të përbashkët të pastrimit midis pesë komunave, anëtare të Ndërkomunales Zadrime është rasti i parë i një bashkëpunimi ndërvendor. Për realizimin e këtij shërbimi është krijuar një strukturë e tillë si Ndërkomunalja Zadrime e cila në veprimtarinë e saj bazohet në solidaritetin midis njërive vendore anëtare nëpërmjet përfaqësimit nga Kryetarët dhe këshilltarët, përfaqësues të forcave politike.

Projekti i realizuar është model i mirë për bashkëpunimin ndërvendor, si në nivel rajonal ashtu edhe atë kombëtar. Njësitë e Qeverisjes Vendore, me karakteristika të përbashkëta dhe në vështirësi për të kryer shërbimet për komunitetet e tyre, mund të bashkëpunojnë mes tyre. Disa nga përfitimet e këtij bashkëpunimi janë kostot e ulta, të kontrollueshme, reale dhe të përballueshme nga tarifat që vetë banorët paguajnë për shërbimin e fituar.

## Qëndrueshmëria e praktikës

Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë aprovuar buxhetet vjetore për shërbimin e pastrimit, bazuar në të ardhurat e pritshme nga tarifat e pastrimit. Buxhetet propozohen nga Komiteti i Drejtimit të Bashkëpunimit Ndërvendor dhe miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ndërkomunales Zadrime. Çdo njësi vendore ka Zyrën e Mjedisit nëpërmjet të së cilës monitorohet ecuria e shërbimit të ofruar. Njësitë vendore delegojnë fondet e nevojshme për kryerjen e shërbimit të pastrimit bazuar në situacionet financiare të përgatitura prej tyre. Komuniteti e ka mirëpritur këtë iniciativë dhe ka mbështetur vazhdimësinë e tij për ofrimin e shërbimit të pastrimit.





Anekset  
për konkursin  
e praktikave të mira

## Aneks 1 - Formati i Aplikimit për Praktikën e Mira

<b>Titulli i praktikës:</b>	
<b>Njësia e Qeverisjes Vendore:</b>	
<b>Periudha e zbatimit:</b>	
<b>Autori (ët) e aplikimit</b>	

1. Fusha e aplikimit për praktikën më të mira (shëno X në katrorin pranë emrit të fushës për të cilën po aplikohet)

<input type="checkbox"/>	Menaxhimi i mbetjeve
<input type="checkbox"/>	Planifikimi strategjik
<input type="checkbox"/>	Menaxhimi fiskal dhe financiar
<input type="checkbox"/>	Komunikimi dhe informimi
<input type="checkbox"/>	Bashkëpunimi ndër-NJQV

2. Përshkrimi i problematikës së adresuar (jo më tepër se 100 fjalë)

3. Aktivitetet kryesore dhe rezultatet e arritura (jo më tepër se 150 fjalë)

4. Informimi e pjesëmarrja komunitare (jo më tepër se 100 fjalë)

5. A mund të përshkruhet ndërhyrja si novatore (jo më tepër se 100 fjalë)

6. Qëndrueshmëria e praktikës (jo më tepër se 100 fjalë)

Konfirmoj se informacioni i dhënë në dokumentet e këtij aplikimi është i saktë.

Sinqerisht,

Emri, Mbiemri, firma e titullarit të NJQV-së, vula e NJQV-së



## Kriteret e Vlerësimit të Fazës së Parë

### HAPI 1: kontrolli administrativ

Në mënyrë që të përzgjidhet si një nga NJQV-të për të marrë pjesë në konkursin e praktikave më të mira, NJQV-ja duhet të plotësojë këto kritere bazë që do të vlerësohen nga dldp-ja.

- Afati i dorëzimit të aplikimit është respektuar. Nëse afati nuk është respektuar, aplikanti do të skualifikohet automatikisht.
- NJQV-të aplikante duhet të jenë në territorin e Qarqeve Lezhë e Shkodër. NJQV-të që nuk janë pjesë e këtij territori nuk mund të aplikojnë.
- Nëse aplikimi nuk është i firmosur nga Kryetari i Bashkisë/Komunës mund të mos vlerësohet më tej (dokument i skanuar).

	PO	JO
HAPI 1: KONTROLLI ADMINISTRATIV		
1. Afati i dorëzimit të aplikimit është respektuar		
2. NJQV-të aplikante janë në territorin e Qarqeve Lezhë e Shkodër		
3. Aplikimi është i firmosur		

Në vijim të aprovimit nga stafi i dldp-së, grupi i ekspertëve teknikë do të vazhdojë me hapin tjetër të vlerësimit.

### HAPI 2: vlerësimi i aplikimit

Vlerësimi i praktikave më të mira do të bëhet duke konsideruar ndryshimet në tre nivele në nivel komunitar, qeverisjeje dhe politikash.

**Kriteret e vlerësimit lejojnë** që cilësia e aplikimeve të dorëzuara të vlerësohet në raport me objektivat e konkursit. (shih thirrjen).

Pikëzimi:

Secilit nga kriteret e pikëzimit do t'i jepet një vlerë mes 1 dhe 5 sipas këtij udhëzimi: 1 = shumë dobët; 2 = dobët, 3=mesatar; 4= mirë; 5= shumë mirë.

Pikët	Kuptimi
1	Shumë dobët
2	Dobët
3	Mesatar
4	Mirë
5	Shumë mirë

## Grila e vlerësimit

Kriteret vlerësuese		
HAPI 2:VLERESIMI I APLIKIMIT	Pikët	
1. Çështja e zgjedhur është në një nga fushat e aplikimit (nëse jo praktika merr vetëm një pikë)	/ 5	
2. Problemi i adresuar ka ndikim në komunitet	/ 5	
3. Zbatimi i praktikës së mirë ishte në nivel të tillë sa tregoi rezultate të qarta	/ 5	
4. Metodatat e përdorura ishin novatore	/ 5	
5. Kush mori pjesë në zbatimin e kësaj praktike? Anëtarë të veçantë të stafit, sektori, Këshilli, anëtarë të komunitetit?	/ 5	
6. Publiku ishte informuar mirë rreth kësaj praktike/iniciative	/ 5	
7. Praktika tregon përfshirje të konsiderueshme të komunitetit (entuziazëm/motivim?)	/ 5	
8. A ekzistojnë mundësi për replikimin e kësaj praktike në NJQV-të e tjera?	/ 5	
9. Kjo praktikë/iniciativë ishte e qëndrueshme në terma kohorë afat-mesme, afat-gjatë.	/ 5	
10. A është marrë parasysh në këtë praktikë barazia gjinore, përfshirja sociale?	/ 5	
11. Praktika/iniciativa kishte një qasje ndër-NJQV	/ 5	
12. Cilësi të veçanta të identifikuar nga anëtarët e grupit teknik në raste të veçanta, dhe të njohura si Praktikë më e mirë * (në këtë rast argumentet duhen vendosur në kutinë e komenteve)	/ 5	
<b>Totali i pikëve:</b>	<b>/ 60</b>	
<b>Komente:</b>		

## Aneksi 2: Lista e plotë e Praktikave të Mira të paraqitura për konkurrim

Fusha	Praktika	Qarku			
		Shkodër		Qarku Lezhë	
		Bashki	Komunë	Bashki	Komunë
Menaxhimi i Mbetjeve	1. Administrimi i përbashkët i pesë njësive vendore	Ndërkomunalja Zadrima <sup>1</sup>			
	2. Menaxhimi i Mbetjeve Urbane		Dajç		
	3. Menaxhimi i mbetjeve urbane	Koplik			
	4. Hartimi i planit strategjik për grumbullimin dhe menaxhimin efektiv dhe eficient të mbeturinave urbane		Ana e Malit		
	5. Menaxhimi i mbetjeve		Kelmend		
	6. Menaxhimi i mbetjeve		Kastrat		
		<b>1</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
		<b>5</b>		<b>1</b>	
Planifikimi Strategjik	7. Mobalb” Mobiliteti Urban në Shqipëri, Demo Shkodër.	Shkodër			
	8. Fuqizimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave komunale në Shllak		Shllak		
	9. Hartimi i Planit Strategjik të Komunës Kallmet & zbatimi i tij				Kallmet
	10. Planifikimi strategjik		Vig Mnelle		
	11. Planifikimi strategjik		Shkrel		
	12. Sistemim trotuaresh, ndriçim, unaza sipër qytetit	Fushë Arrëz			
	13. Plani Strategjik i Zhvillimit Vendor		Gruemire Koplik		
	14. Pyllëzim me fidanë arrë		Qerret		
	15. Ngritja e një parku të gjelbërt—Suka Blinisht				Blinisht
	16. Sistemim asfaltim i rrugës Gorre-Gurëz				Fushë Kuqe
17. Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Mabe.				Dajç	
		<b>2</b>	<b>5</b>	<b>0</b>	<b>4</b>
		<b>7</b>		<b>4</b>	

<sup>1</sup> Ndërkomunalja Zadrima përfshin NJQV nga Lezha dhe Shkodra. Është përfshirë tek Lezha pasi aty është qendra.

Fusha	Praktika	Qarku			
		Shkodër		Qarku Lezhë	
		Bashki	Komunë	Bashki	Komunë
Menaxhimi Fiskal & Financiar	1. Menaxhimi fiskal dhe financiar "Buxhetimi me pjesëmarrje"				Orosh
	2. Buxhetimi me pjesëmarrje			Lezhë	
	3. Hartimi dhe rishikimi i Programit Buxhetor Afatmesëm		Dajç		
	4. Menaxhimi fiskal dhe financiar "Buxhetimi me pjesëmarrje"				Fan
	5. Mbledhja e taksave dhe tarifave vendore				Kaçinar
	6. Menaxhimi fiskal dhe financiar		Shkrel		
		0	2	1	3
		2		4	
Komunikimi dhe Informimi	7. Ndërtimi i Zyrës me Një Ndalesë (Z1N).		Bushat		
	8. One Stop Shop (Faza I): Mjedisi Fizik			Lezhë	
	9. Informim, komunikim dhe shërbim online ndaj qytetarëve, turistëve dhe bizneseve nëpërmjet Z1N		Velipojë		
	10. Komunikimi dhe informimi	Pukë			
	11. Z1N dhe website, mjete informim-komunikimi dhe rritje të ardhurash vendore				Kallmet
	12. Krijimi i një biblioteke në qytetin Reps				Orosh
	13. Shtimi i sipërfaqes së gjelbër në qytet, kontribut vullnetar dhe pjesëmarrje qytetare			Rrëshen	
		1	2	2	2
	3		4		
Bashkëpunimi ndër NJQV	14. Bashkëpunimi ndërvendor për projektin "Ndërtimi i rrugëve të bashkëpunimit turistik nëpërmjet zhvillimit të produkteve të artizanatit" IPA/CBC (Guri Zi, Këshilli i Qarkut Shkodër)		Guri Zi		
	15. Bashkëpunimi ndërvendor (Pukë, Qerret & Rrape)	Pukë			
	16. Bashkëpunimi Ndërvendor/ Menaxhimi i Mbetjeve (komuna Dajç dhe Blinisht, Qarku Lezhë; Bashkia Vau Dejës dhe komunat Bushat & Hajmel, Qarku Shkodër)				Blinisht
	17. Bashkëpunimi ndër-NJQV				Kthellë
	18. Strategjia dhe plani i veprimit për shërbimin e vizitorit		Velipojë		
		1	2	0	2
	3		2		
	5	15	3	11	
Totali	20		15		

Fushat	Gjithsej		Qarku			
			Shkodër		Lezhë	
	Bashki	Komuna	Bashki	Komuna	Bashki	Komuna
1. Menaxhimi i Mbetjeve	1	5	1	4	0	1
2. Planifikimi Strategjik	2	9	2	5	0	4
3. Menaxhimi Fiskal dhe Financiar	1	5	0	2	1	3
4. Komunikimi dhe Informimi	3	4	1	2	2	2
5. Bashkëpunimi ndërvendor	1	4	1	2	0	2
	8	27	5 4 NJQV	15 12 NJQV	3 2 NJQV	12 8 NJQV
<b>Totali</b>	<b>35</b> <b>26 NJQV</b>		<b>20</b> <b>16 NJQV</b>		<b>15</b> <b>10 NJQV</b>	

### Aneksi 3: Lista e Praktikave të përzgjedhura nga vlerësimi i parë

Fusha	Praktika	Qarku			
		Shkodër		Qarku Lezhë	
		Bashki	Komune	Bashki	Komunë
Mena-xhimi i Mbetjeve	1. Administrimi i përbashkët i pesë njësive vendore	Ndërkomunalja Zadrime <sup>2</sup>			
	2. Menaxhimi i Mbetjeve Urbane		Dajç		
	3. Menaxhimi i mbetjeve urbane	Koplik			
		<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
		<b>2</b>		<b>1</b>	
Planifikimi Strategjik	4. MobalB” Mobiliteti Urban në Shqipëri, Demo Shkodër.	Shkodër			
	5. Fuqizimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave komunale në Shllak		Shllak		
	6. Hartimi i Planit Strategjik të Komunës Kallmet dhe zbatimi i tij				Kallmet
		<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>
		<b>2</b>		<b>1</b>	
Menaxhimi Fiskal & Financiar	7. Menaxhimi fiskal dhe financiar “Buxheti me pjesëmarrje”				Oros
	8. Buxheti me pjesëmarrje			Lezhë	
	9. Hartimi dhe rishikimi i Programit Buxhetor Afatmesëm		Dajç		
		<b>0</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
		<b>1</b>		<b>2</b>	
Kunikimi dhe Informimi	10. Ndërtimi i Zyrës me Një Ndalesë (Z1N).		Bushat		
	11. One Stop Shop (Faza I): Mjedisi Fizik			Lezhë	
	12. Informim, komunikim dhe shërbim online ndaj qytetarëve, turistëve dhe bizneseve nëpërmjet Z1N		Velipojë		
		<b>0</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>0</b>
		<b>2</b>		<b>1</b>	
Bashkëpunimi ndër NJQV	13. Bashkëpunimi ndërvendor për projektin “Ndërtimi i rrugëve të bashkëpunimit turistik nëpërmjet zhvillimit të produkteve të artizanatit” IPA/CBC (Guri Zi, Këshilli i Qarkut Shkodër)		Guri Zi		
	14. Bashkëpunimi ndërvendor (Pukë, Qerret & Rrape)	Pukë			
	15. Bashkëpunimi Ndërvendor/Menaxhimi i Mbetjeve (komuna Dajç dhe Blinisht, Qarku Lezhë; Bashkia Vau Dejës dhe komunat Bushat & Hajmel, Qarku Shkodër)				Blinisht
		<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>
		<b>2</b>		<b>1</b>	
		<b>3</b>	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>4</b>
Totali		<b>9</b>		<b>6</b>	

<sup>2</sup> Ndërkomunalja Zadrime përfshin NJQV nga Lezha dhe Shkodra. Është përfshirë tek Lezha pasi aty është qendra.

## Aneksi 4: Tabela Krahasuese e Praktikave të Mira pjesëmarrëse në Konkursin e Parë (2010) dhe të Dytë (2011)

Tabela 3/2: Lista e plotë e NJQV që kanë aplikuar në Konkursin Rajonal të Praktikave të Mira 2013 dhe 2010

Fusha	2013				2010				Fusha
	Qarku				Qarku				
	Shkodër		Lezhë		Shkodër		Qarku Lezhë		
Bashki	Komune	Bashki	Komune	Bashki	Komune	Bashki	Komune		
Planifikimi Strategjik	Shkoder Fushe Arr.	Shllak Vig Mnelle Shkrel Gruemire (Koplik) Qerret		Kallmet Fushe K. Blinisht Dajc	Shkodër Vau Dejës	Bushat Vig Mn. 2 Shkrel Hajmel	Rubik + Rrëshen	Milot 2 Fushe Kuçe Blinisht Orosh Kthelle	Planifikimi Strategjik
	2	5 6 NJQV	0	4	2	5 4 NJQV	1 2 NJQV	7	
	7 8 NJQV		4 4 NJQV		7 6 NJQV		8		
Menaxh. Fisk&Fin		Dajc Shkrel	Lezhe	Orosh Fan Kacinar	Vau Dejës Koplik	Kastrat Bushat Mnelle Vig Hajmel Qafë Mali		Kallmet Milot	Menaxh. Fisk&Fin
	2	2	1	3	2	5	0	2	
	2		4		7		2		
Menaxhimi Mbetjeve	Koplik	Dajc Aba Malit Kelmend Kastrat		Zadrima	Shkodër 2 Fushe Arrëz 2 Puke 2 Koplik	Blerim Guri Zi Mnelle Vig 2 Velipojë Gjegjan Dajc Gruemire Rrape 2	Lezhë	Balldre 2 Kthelle 2 Orosh Kallmet 2 Dajc Fan Hajmel 2	Përmirësimi i shërbimeve publike
	1	4	0	1	7	10	1	11	
	5		1 5 NJQV		17		11		
Kom& Inf	Puka	Bushat Velipojë	Lezha Rrëshen	Kallmet Orosh		Dajc Bushat Guri Zi		Kallmet	Kom& Inf
	1	2	2	2	0	3	0	1	
	3		4		3		1		
Bashkëpunimi ndër NJQV	Pukë	Guri Zi Velipojë		Blinisht Kthelle		Ana e Malit Rrape Blerim	Rubik + Rreshen	Dajc + Vau Dejës Orosh	Bashkëpunimi ndër NJQV
	1	2	0	2	0	3	1 2 NJQV	2 3 NJQV	
	3		2		3		3 5 NJQV		
	5	15	3	12	11	26	3	23	
	20		15		37		26		
	35				63				

**Tabela krahasuese e rezultateve të fazës së parë të vlerësimit në dy konkurset rajonale të vitit 2010 dhe 2013**

Fusha		2013				2010				Praktika
		Qarku				Qarku				
		Shkodër		Qarku Lezhë		Shkodër		Lezhe		
		Bashki	Kom.	Bashki	Kom.	Bashki	Kom.	Bashki	Kom.	
Planifikimi Strategjik	Mobalb" Mobiliteti Urban në Shqipëri, Demo Shkodër.	Shkodër				Shkodër				Plani Strategjik i Zhvillimit në kuadër të programit DELTA
	Fuqizimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave komunale në Shllak		Shllak						Orosh	Hartimi i Planit Strategjik të Zhvillimit
	Hartimi & Zbatimi i Planit Strategjik te Komunës Kallmet				Kallmet				Milot	Zhvillimi i Planit Strategjik
		1	1	0	1	1	0	0	2	
		2		1		1		2		
Menaxhimi Fiskal & Financiar	Menaxhimi fiskal dhe financiar "Buxhetimi me pjesëmarrje"				Orosh	Koplik				Menaxhimi i taksave dhe tarifave lokale
	Buxhetimi me pjesëmarrje			Lezhë		Vau Dejës				Buxheti me pjesëmarrje
	Hartimi dhe rishikimi i Programit Buxhetor Afatmesëm		Dajç				Bushat			Ofrim shërbimi, mbledhje të ardhura
		0	1	1	1	2	1	0	0	
		1		2		3		0		
Kommunikimi dhe Informimi	Ndërtimi i Zyrës me Një Ndalesë Z1N		Bushat				Dajç			Krijimi i Z1N
	Informim, komunikim dhe shërbim online ndaj qytetarëve, turistëve dhe bizneseve nëpërmjet Z1N		Velipojë						Kallmet	Informim, komunikim dhe pjesëmarrje qytetare
	One Stop Shop (Faza I): Mjedisi Fizik			Lezhë			Guri Zi			Pjesëmarrja qytetare në vendosjen e prioriteve
		0	2	1	0	0	2	0	1	
		2		1		2		1		



Fusha	2013				2010				Praktika
	Qarku				Qarku				
	Shkodër		Qarku Lezhë		Shkodër		Lezhe		
	Bashki	Kom.	Bashki	Kom.	Bashki	Kom.	Bashki	Kom.	
Bashkëpunimi ndër N-JQV	Bashkëpunimi ndërvendor "Ndërtimi i rrugëve të bashkëpunimit turistik nëpërmjet zhvillimit të produkteve të artizanatit" IPA/CBC		Guri Zi + Këshilli i Qarkut Shkodër				Ana e Malit		Përgatitja e projektit dhe aplikimi në kuadrin e IPA
	Bashkëpunimi Ndërvendor (Pukë, Qerret & Rrape)	Pukë						Dajc + Vau Dejës	Bashkëpunimi i 5 komunave në ndërkomunalen Zadrima
	Bashkëpunimi Ndërvendor (5 NJQV te "Zadrima") Menaxhimi i Mbetjeve				Blinisht			Rubik + Rrëshen	Plani Strategjik i Zhvillimit të Mancommunities
		<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
		<b>2</b>		<b>1</b>		<b>1</b>		<b>2</b>	
		<b>2</b>	<b>5</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>4</b>
	<b>Totali</b>	<b>7</b>		<b>5</b>		<b>7</b>		<b>5</b>	

## Aneksi 5: Paketa e vlerësimit të Praktikave (faza e dytë)

Forma e Vlerësimit të Praktikave të Mira nga Juria

Nr.	Përshkrim i kriterëve vlerësuesë	Vlerësimi	Anëtari 1	Anëtari 2	Anëtari 3	Anëtari 4	TOTALI
<b>1A</b>	<b>VLERËSIMI I PËRMBAJTJES SË PRAKTIKËS</b>	<b>60 / 100</b>					
	Prezantimi dhe aplikimi shprehën qartësisht;						
1.1	- Suksesin	____/15					
1.2	- Impaktin	____/15					
1.3	- Transparencën dhe pjesëmarrjen	____/10					
1.4	- Novacionin	____/10					
1.5	- Mundësinë e replikimit	____/10					
<b>2B</b>	<b>VLERËSIMI I PREZANTIMIT TË PRAKTIKËS</b>	<b>40/100</b>					
2.1	Folësi (t) tregon entuziazëm/ është bindës/energjik (p.sh. eviton leximin e shënimeve)	____/10					
2.2	Tregon qartësi mendimi	____/10					
2.3	Pyetjeve të drejtuara/komenteve iu përgjigjet në mënyrë të plotë dhe bindëse	____/10					
2.4	Koha u përdor në mënyrë efektive për prezantimin e praktikës dhe brenda limitit të 10 minutave	____/10					
	<b>TOTAL I PIKËVE</b>	<b>____/100</b>					

Totali pikëve \_\_\_\_\_.

Përmbledhja u përgatit nga \_\_\_\_\_, Përfaqësues i dldp-së.

Firma e anëtarëve të Jurisë

Anekset  
pär konkursin  
e projektit mē tē mirē



## Aneks 1: Formati i aplikimit për projektin më të mirë me udhëzimet përkatëse.

Udhëzues për plotësimin e formatit të aplikimit për Njësitë Vendore që duan të marrin pjesë në konkursin për projektin më të mirë të financuar nga granti I dldp 2

<b>Titulli i projektit:</b>	Ju lutem shkruani këtë titullin e projektit ashtu si figuron në dokumentet e deritanishëm
<b>Njësia e Qeverisjes Vendore:</b>	
<b>Periodha e zbatimit:</b>	Muaji/viti i fillimit-Muaji/viti i përfundimit të projektit
<b>Autori (ët) e aplikimit</b>	Emri, pozicioni në lidhje me projektin dhe kontakti përkatës e-mail e telefon

### 1. Përmbledhje e projektit (jo më tepër se 1 faqe)

*Ju lutem rendisni disa indikatorë sasiorë kryesorë të zbatimit të projektit:*

*Kosto e parashikuar e projektit dhe kosto finale e tij*

*Kohëzgjatja e parashikuar e projektit dhe kohëzgjatja reale e tij*

- *Numri i parashikuar i përfituesve*
- *Kosto për përfitues, llogaritur mbi koston përfundimtare të projektit*
- *Indikatorë në nivel outputi sipas tipit të projektit: të shprehur në m2 për infrastrukturë; nr. i familjeve të shërbyera me shërbimin e pastrimit dhe territori i mbuluar nga ky shërbim; nr. i kërkesave të përgjigjura në zyrat me një ndalesë etj.*

### 2. Indikatorët e zbatimit të projektit (jo më tepër se ½ faqe)

*Ju lutem rendisni disa indikatorë sasiorë kryesorë të zbatimit të projektit:*

*Kosto e parashikuar e projektit dhe kosto finale e tij*

*Kohëzgjatja e parashikuar e projektit dhe kohëzgjatja reale e tij*

*Numri i parashikuar i përfituesve*

*Kosto për përfitues, llogaritur mbi koston përfundimtare të projektit*

*Indikatorë në nivel outputi sipas tipit të projektit: të shprehur në m2 për infrastrukturë; nr. i familjeve të shërbyera me shërbimin e pastrimit dhe territori i mbuluar nga ky shërbim; nr. i kërkesave të përgjigjura në zyrat me një ndalesë etj.*

### 3. Cilësia e procesit të prokurimit (jo më tepër se ½ faqe)

*A u zhvillua procesi i prokurimit më tepër se një herë, nëse po cila ishte arsyeja?*

*Sa kompani morën pjesë, nga te cilat sa u kualifikuan?*

*A kishte ulje të vlerës së ofertës në raport me vlerën e shpallur për prokurim dhe sa ishte kjo ulje në %?*

### 4. Cilësia e zbatimit të projektit (jo më tepër se ½ faqe)

- *A u zbatua projekti në kohëzgjatjen e parashikuar? Nëse pati vonesa, a ishin këto të justifikuara ?*
- *A pati probleme të rëndësishme gjatë zbatimit vënë në dukje nga raportet e supervisorit apo vizitat në terren nga stafi i dldp-së? Nëse po, si u zgjidhën ato?*
- *Cili ishte niveli i kënaqësisë së përfituesve me cilësinë e projektit të përfunduar ? Jepni shifra konkrete bazuar tek pyetësorët me komunitetet përfituese*

### 5. Cilësia e pjesëmarrjes së komuniteteve përfituese (grave në veçanti) gjatë projektit (jo më tepër se 1 faqe)

#### **Informimi i qytetarëve gjatë zbatimit të projektit**

*Bazuar në informacionet nga NJQV-ja, ju lutem përshkruani metodat e përdorura nga NJQV-ja për shpërndarjen e informacionit në lidhje me projektin.*

#### **Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e komunitetit gjatë zbatimit të projektit.**

*Ju lutem përshkruani nëse komunitetet përfituese kanë patur ndonjë rol gjatë zbatimit të projektit dhe nëse NJQV-ja ka bërë përpjekje të organizuara për përfshirjen e komunitetit përfitues në zbatimin e projektit.*

*Sa te kënaqur ishin përfituesit nga niveli i informacionit të ndarë dhe pjesëmarrjes në projekt? Ju lutem referohuni nivelit të përfituesve sipas pyetësorit të komunitetit.*

#### **Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e grave gjatë hartimit dhe zbatimit të projektit dhe përqindja e grave përfituese nga projekti.**

*Në hapësirën e mëposhtme raportoni rreth pjesëmarrjes së grave në aspekte të ndryshme të projektit, p.sh punësimi gjatë projektit, pjesëmarrja e grave në administratë në zbatimin e projektit, përfitimi i veçantë i grave nga zbatimi i projektit etj. Ju lutem jeni sa më specifik dhe raportoni me të dhëna sasiore.*

## 6. Vizibiliteti i projektit (jo më tepër se ½ faqe)

***Ju lutem detajoni aktivitetet e kryera për t'i dhënë vizibilitet projektit:***

*Këtu mund të përfshihen shkrimet në gazeta, kronikat në lajme, aktivitete të tjera informuese e ndërgjegjësuese që kanë arritur një audiencë të gjerë.*

## 7. Qëndrueshmëria e projektit (jo më tepër se ½ faqe)

*Ju lutem shpjegoni këtu (sa më konkretisht) masat e ndërmarra për qëndrueshmërinë institucionale e financiare të projektit.*

*A është parashikuar buxhet i mjaftueshëm e organizim institucional përgjegjës për menaxhimin, funksionimin e mirëmbajtjen e produkteve të projektit.*

## 8. Ndikimi në financat vendore (jo më tepër se ½ faqe)

*A do të ketë ndikim afatgjatë projekti në financat vendore të Njësisë Tuaj Vendore?*

*Mendoni rreth këtyre linjave:*

- A janë shtuar taksa apo tarifa të reja vendore si shkak i realizimit të projektit?*
- A mundet projekti të kontribuojë në përmirësimin e mbledhjes së taksave apo tarifave?*
- A mundet projekti të kontribuojë në shkurtimin e shpenzimeve ekzistuese?*

## 9. Ndikimi në ngritjen e kapacitetit të stafit të NJQV-së (jo më tepër se ½ faqe)

*Përshkruani këtu ndikimin e të gjithë ciklit të projektit (trajnim, shkrim projekti, zbatim, raportim) në ngritjen e kapacitetit të stafit të Njësisë Vendore.*

*Përshkruani rreth këtyre linjave kryesore:*

*- Numri i stafit të NJQV-së së trajnuar në fusha të ndryshme të menaxhimit të projekti. A ishte ky staf i qëndrueshëm gjatë zbatimit të projektit?*

*- A ndikoi ushtrimi i hartimit të projekt-propozimit për më tepër akses në fonde të tjera, (ju lutem ilustrojeni me shembuj konkretë)?*

*- A është përdorur përvoja e projektit nga stafi që është marrë me të në zbatimin e projekteve të tjera të ngjashme (ju lutem ilustrojeni me shembuj konkretë) ?*

## 10. Të tjera ( jo më tepër se 1 faqe pa materialet bashkangjitur )

*Ju mund të rendisni këtu informacione të tjera që nuk janë përshkruar më sipër dhe mendoni se janë të rëndësishme për grupin që do të bëjë vlerësimin për projektin më të mirë.*

*Gjithashtu ju mund t'i bashkangjisni këtij aplikimi materiale të tjera të printuara apo elektronike që i gjykoni të rëndësishme për suksesin e aplikimi tuaj.*

Konfirmoj se informacioni i dhënë në dokumentet e këtij aplikimi është i saktë.

Sinqerisht,

\_\_\_\_\_

Emri, Mbiemri, firma e titullarit të NJQV-së, vula e NJQV-së



## Aneks 2: Kriteret e vlerësimit në fazën e parë

Kriteret për përzgjedhjen e projektit më të mirë me pikëzimin përkatës

### HAPI 1: Kontrolli administrativ

Në mënyrë që të përzgjidhet si një nga NJQV-të për të marrë pjesë në konkursin e projektit më të mirë, NJQV-ja duhet të plotësojë këto kritere bazë që do të vlerësohen nga dldp-ja.

- Afati i dorëzimit të aplikimit është respektuar. Nëse afati nuk është respektuar, aplikanti do të skualifikohet automatikisht.
- NJQV-të aplikante duhet të jenë në territorin e Qarqeve Lezhë e Shkodër. NJQV-të që nuk janë pjesë e këtij territori nuk mund të aplikojnë.
- Nëse aplikimi nuk është i firmosur nga Kryetari i Bashkisë/Komunës mund të mos vlerësohet më tej.

	PO	JO
<b>HAPI 1 : KONTROLLI ADMISTRATIV</b>		
1. Afati i dorëzimit të aplikimit është respektuar		
2. NJQV-të aplikante janë në territorin e Qarqeve Lezhë e Shkodër		
3. Aplikimi është i firmosur		

**Në vijim të aprovimit nga stafi i dldp-së, grupi i ekspertëve teknikë mund të vazhdojë me hapin tjetër të vlerësimit.**

### HAPI 2:VLERËSIMI I APLIKIMIT

**Kriteret e vlerësimit lejojnë** që cilësia e aplikimeve të dorëzuara të vlerësohet në raport me objektivat e konkursit. (shih thirrjen).

#### **Kriteret vlerësuese janë si më poshtë:**

- Cilësia e shkrimit të projekt-propozimit **(0 deri në 10 pikë)**

Pikët e marra nga vlerësimi	Projekti ka marrë më pak se 50 pikë	Projekti ka marrë 50-59 pikë	Projekti ka marrë 60 deri në 69pikë	Projekti ka marrë më shumë se 70 pikë
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	3	5	10

- Indikatorët bazë të projektit **(0 deri në 20 pikë)**

Indikatorët e projektit	Dobët	Mesatar	I mirë	Shumë i mirë
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	5	10	20

- Cilësia e prokurimit të projektit **(0 deri në 10pikë)**

Cilësia e prokurimit të projektit	Dobët	Mesatar	I mirë	Shumë i mirë
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	3	5	10

- Cilësia e zbatimit të projektit **(0 deri në 20pikë)**

Cilësia e zbatimit të projektit	Dobët	Mesatar	I mirë	Shumë i mirë
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	5	10	20

- Informimi dhe pjesëmarrja qytetare gjatë zbatimit të projektit **(0 deri në 10 pikë)**

Niveli i informimit dhe pjesëmarrjes qytetare	Nuk ka patur ndonjë përpjeke serioze nga ana e NJQV-së	Disa përpjeke sporadike	Informacion i vazhdueshëm dhe i organizuar	Pjesëmarrje aktive e komunitetit gjatë zbatimit.
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	3	5	10

- Promovimi i barazisë gjinore nëpërmjet projektit **(0 deri në 10 pikë)**

Barazia gjinore	Nuk ka patur ndonjë përpjeke serioze nga ana e NJQV-së	Disa përpjeke sporadike	Projekti ka punësuar gra në mënyrë intensive	Shumica e përfituesve të projektit janë gra
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	3	5	10

- Qëndrueshmëria afatgjatë e projektit **(0 deri në 10 pikë)**

Qëndrueshmëria	Dobët	Mesatare	E mirë	Shumë e mirë
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	3	5	10

- Ndikimi në ngritjen e kapacitetit të stafit të NJQV-së **(0 deri në 10 pikë)**

Kapaciteti i stafit	Dobët	Mesatare	I mirë	Shumë i mirë
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	3	5	10

### Aneks 3: Kriteret e vlerësimit në fazën e dytë

Kriteret për përzgjedhjen e projektit më të mirë me pikëzimin përkatës

Nr.	Përshkrim i kritereve vlerësuese	Vlerësimi
<b>1</b>	<b>VLERËSIMI I PËRMBAJTES SË PROJEKTIT</b>	<b>/ 100</b>
	Aplikimi për projektin më të mirë dhe prezantimi qartësisht shprehu;	
1.1	- Suksesin	___/10
1.2	- Impaktin	___/10
1.3	- Transparencën dhe pjesëmarrjen	___/10
1.4	- Novacionin dhe mundësinë e replikimit	___/10
<b>2</b>	<b>VLERËSIMI I PREZANTIMIT TË PRAKTIKËS</b>	<b>/100</b>
2.1	Folësi (t) tregon entuziazëm/ është bindës/energjik dhe tregon qartësi mendimi	___/10
2.3	Pyetjeve të drejtuara/komenteve iu përgjigjet në mënyrë të plotë dhe bindëse	___/10
2.4	Koha u përdor në mënyrë efektive për prezantimin e praktikës dhe brenda limitit të 10 minutave	___/10
2.5	Vlerësim shtesë për cilësinë e materialeve të ekspozuara në (materiale të publikuara, grafika, foto, PowerPoint etj.)	___/10
<b>3</b>	<b>MBRESAT NGA VIZITA NË TERREN</b>	<b>/20</b>
3.1	Anëtar i Jurisë duhet të vendosë (pikë të ndryshme, nga 0 në 20 për projektet sipas përshtypjeve të krijuara nga vizita në terren	___/20
	<b>TOTAL I PIKËVE</b>	<b>___/100</b>

Anëtar i Jurisë (firma)

\_\_\_\_\_

## Aneks 4: Lista e projekteve që aplikuan (me të zezë projektet e kualifikuara për në fazën e dytë

Qarku	NJQV	Projekti
Shkodër	<b>Bashkia Shkodër</b>	<b>“Rehabilitimi i lulishtes në zonën industriale”</b>
	Bashkia Puke	“Organizim i përbashket Ndërvendor për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Puke, Komunitat Qerret dhe Rrape” Qarku Shkodër”
	Bashkia Koplík	“Plani i zhvillimit Lokal të Bashkisë Koplík ”
	Bashkia Vau i Dejes	“Ndërtim Parku Rekreativ pas pallateve 5 katëshe ”
	Komuna Bushat	“Ndërtimi i zyrës me një ndalesë ”
	<b>Komuna Guri i Zi</b>	<b>“Vënia në Eficencë të plotë të Ujësjetës të Gurit të Zi”</b>
Lezhe	<b>Bashkia Lezhe</b>	<b>“Ndërtimi i murit rrethues dhe sistemime të kompleksit të shkollave në Lagjen “Beslidhja ”</b>
	Bashkia Rubik	“Hartimi e zbatimi i Planit Ndërvendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve urbane në bashkinë Rubik dhe Rrëshen, Qarku Lezhe”
	Komuna Dajc Lezhe & Komuna Hajmel Shkodër	“Grumbullimi i diferencuar i mbeturinave urbane në Komunitat Dajc e Hajmel dhe ndërtimi i një Qendre Riciklimi në Komunën Dajc ”
	<b>Komuna Kallmet</b>	<b>“Informim, Komunikim dhe pjesmarrje e qytetareve (Ndërtimi i Zyrës me një Ndalesë)”</b>
	<b>Komuna Orosh</b>	<b>“Ndërtim lulishteje në qytetin Rejs, Komuna Orosh”</b>